“Trupa” ose zonat minerale njesohen me horizontet e shkembijnje ultrabazike, te cilet veçohen njeri nga tjetri prej trupash ose dajkash gabroolivinitesh, plagioklazitesh, gabropegmatitesh shterpe, ose me permbajtje te paket titanomagnetiti. Permbajtja e magnetitit ne te luhatet ne 5-20 % e rralle, deri ne 30-40 % te mases se shkembit. Nderkaq permbajtja e sulfureve leviz ne 1-6 % te mases se pergjithshme te shkembit. Mbizoterojne kokrrizat e magnetitit “paresor”, me trajta te shrrregullta deri ne te zgjatura. Ka magnetit “dytesor”, ne trajte damaresh me pamje rrjetore neper masen e olivines, dhe sipas rrafshëve te shpetezimit te piroksenit, gjithashtu ne trajte pluhuri e kokrriza te vogla me permasa rreth 0.02 mm.

Duke u bazuar ne studimet petrografike e mineralogjike, rezulton se mineralizimi i magnetitit te “zones kalimtare”, ose kumulative ultrabazike - bazike, eshte formuar ne disa stadi - gjeneracione te etapes magmatike : kokrrizat e veçanta te magnetitit, qe ndonjehere shoqerohen me ato te titanomagnetitit (rralle me ato te kromitit), i perkasin stadi te hershem te segregacionit. Sasia tjeter e magnetitit, ne trajte pikezimesh te vogla, te imta pluhuri, damarthesh, rrjetash, njollash, i perkasin stadi autometamorfik, te ndryshimit te shkembijnje, lidhur me serpentinizimin, asbestizimin, boulingitizimin etj.

b. Formacion magnetit-ilmenitik dhe fusha xeherore e Kashnjetit

Ky formacion xeheror lidhet kryesisht me kompleksin shkembor kumulativ gabro-peridotit, me pjesen bazike te tij, dhe eshte me i rendesishem per rezervat, mundesine e pasurimit e te perdorimit praktik. Perfaqesimin me te plote e ka ne zonen e Kashnjetit, me vendburimin e Sukaxhis, objektet Ungre, Fregen, Thanës etj. (Çaku etj. 1974, Teršana 1982). Karakteristikat kryesore te tyre jepen ne pasqyren 1. Ne kete zone masivet gabro-peridotit shquhen si komplekse kumulative, qe ne pjesen e mesme e te siperme marrin trajten e masiveve te vegjel gabroide, te zgjatur, me shtrirje afrimeridionale, me raport gjatesi-gjeresi nga 3:1 deri 8:1, siç eshte masivi ferrogabror i Sukaxhi-Thanezes (Teršana 1982; Çina etj. 1987) (Fig.3).

Masivet e “vegjel” ndertohen prej shkembijnje gabrore te llojeve magneziale, hekurore, amfibolike e gabrodiabaze, dhe ne ndonje rast gabro-gabrodiarite me apatit (Teršana, 1986). Ne to here-here dallohet qarte ndertimi brezor, nderthurja e brezave trashmane te troktoliteve, gabro-pirokseniteve, melanogabrove, mazogabrove, leukogabrove, ne dallim me gabrot izotropike te brezit lindor. Dallimi facial ne litotipet pasqyrohet dhe ne aspektin petrokimik e metalogjenik: ne permbajtjen me te larte te titanit dhe hekurit, dhe ne pranine e mineralizimit te hekur-titanit.

Prania e mineralizimit hekur-titan-vanad, shprehet me pranine e shoqerimit mineral xeheror magnetit-ilmenit. Ne kete rast te dy mineralet xeherore kryesore formojne lidhje mekanike, jane te ndashem nga njeri-tjetri, pra relativisht te lehta per pasurim. Por nderkaq ato gjithmone shoqerohen me nje sasi xeherori titanomagnetiti te vertete (ku magnetiti dhe ilmeniti formojne nje bashkeshoqerim me mikrostrukture rrjetore te ndarjes se solucioneve te ngurta) (Kati 1986). Ky xeheror eshte pothuajse i pandashem, i papasurueshem me rruge mekanike (Kaltani 1979). Ne vendburim Sukaxhise zakonisht trupat xeherore te mineralizimit te hekur-titanit kane forma brezash, pseudobrezash, te nderthurur, te melanogabrove xeheror-mbartese me ato te leukogabrove shterpe. Xeheroret jane te tipeve me pikezime, njolllore, shlirore, zinxhirore e deri masiv, zakonisht me strukture sideronite. Ato futen ne llojin e varfer magnetito-ilmenitik dhe titanomagnetite vanadmbajtes, te cilet paraqesin interes studimi kompleks gjeologo-mineralogjik e teknologjik.

Xeherori i titanomagnetitit i vendburimit Sukaxhi (Kashnjet) eshte trajtuar ne rruge te ndryshme pasurimi (gravimetrik me magnetik).

c. Formacioni titanomagnetitik dhe fusha xeherore e Kaçinarit

Ky formacion xeheror karakterizohet nga zoterimi i mineralit të titanomagnetitit (magnetiti dhe ilmeniti të bashkëritur në trajtën e solucioneve të ngurta) e me pak të ilmenitit. Ai paraqitet në pikezime, ose në agregate të shpërndara pa rregull në masën silikate. Është ksenomorf e formon strukturën sideronite të shkëmbit. Përqendrohet në gabro, e sidomos në gabrodiabazet me struktura tipike gabro-ofitike, diabazike.

Perfaqëson një mineralizim të varfër të vështirë për pasurim mekanik, por me rezervë potenciale (Tershana, 1982). Perfaqësimin me të plote e ka në zonën e Kaçinarit. Në këto zone kanë përhapje të mëdha shkëmbinjtë ultrabazike dhe gabroide e gabrodiabazet si pjesë të kompleksit plutonogjen dhe lavat jastekore diabaz-spilitike, si pjesë të kompleksit vullkanogjen. Një vend të veçantë në mesin e këtyre kompleksëve shkëmborë zënë gabrodiabazet, që mund të konsiderohen si tavan i formimeve magmatike plutonogjene bazike, kalimtare për në diabazet e mirefillta. Në Kaçinar gabrodiabazet zënë pjesën qendrore të plutonit gabror. Ato janë diku leukokrate diku mezokrate e me rralle melanokrate. Të fundit janë lloje shkëmbore kryesore me përmbajtje xeherori titanomagnetiti. Në Kaçinar formojnë një fushë të mineralizuar me një sërë shfaqjesh xeherore, që në sipërfaqe ka përmasa në gjatësi rreth 1200 m e në gjerësi rreth 1000 metra. Gjetke gabrodiabazet konsiderohen me tepër si pjesë të mirekristalizuara të lavave jastekore bazike.

- Gabrodiabazet përshkohen dendur nga dajka e damarë të shumta gabronoritësh, hornblenditësh, mikrogabrosh, gabropegmatitësh, plagioklazitësh, porfiritesh dioritike e mikrodioritike etj. shpesh të shoqëruar me xeherore. Zhvillimi i madh i serisë damarore tregon se gabrodiabazet kanë qenë arene e depertimit të llojeve të ndryshme dajkore (me përberje bazike, mesatare, mezoacide), me të dhe e depozitimit të mineraleve metalore e jometalorë hidrotermale. Mineralizimi i titanomagnetitit në gabrodiabazet i përket fazës me të hershme magmatike, ndërsa ai i serisë damarore (që mund të jetë titanomagnetit, titanomagnetit-ilmenit, ilmenit-titanomagnetit ose thjeshtë ilmenitik) i përket një faze me të vonë.

- Masivi gabrodiabazik i Kaçinarit me mineralizim titani-hekuri-vanadmbajtes, është formuar në kushte hipoabisale, të thellesive të vogla, gjë që ka kushtëzuar, për shkëmbin, formimin e struktura gabrofitike, dhe për xeherorin mikrostrukturën e ndarjes së tretësirës së ngurta (në temperaturën eutektike 400-700°).

- Nga ana e tyre shkëmbinjtë dajkore, e mineralizimi i lidhur me të, i përket të njëjtes etape magmatike, por me kohë intrudimi të ndryshme, ç'ka vërtetohet dhe nga orientimi i ndryshëm i dajkave, damarëve të përberjeve të ndryshme. Në këto masiv në përgjithësi është mjaft karakteristike dukuria e leukoksenizimit të mineraleve xeherore titanifere në kushtet e hipergjenezes.

- Në shfaqjet e objektet e mineralizuara të hekur-titanit të brezit ofiolitik perendimor mund të veçojmë disa etapa mineralizimi:

Etapa magmatike e hershme ose e vërtetë, e cila pasqyrohet me formimin e mineraleve silikate (piroksen, olivine, plagioklaz, e me rralle amfibol e biotit).

- Etapa intramagmatike e segregacionit, që shprehet me formimin e mineraleve xeherore, si magnetiti, ilmeniti, titanomagnetiti dhe ndonjë mineral sulfur, që duke mbushur boshllëqet ndërmjet kokrrizave silikate, formojnë strukturën sideronite, ose të çimentimit.

- Paksa me vonë në këto mjedis tashme të konsoliduar zhvillohet seria dajkore, që përshkon mbare kompleksin ofiolitik, (mikro-gabrot, plagioklazitet, gabropegmatitet, gabronoritët korrize vogla etj.), që here-here përmbajnë mineralizim titanomagnetiti singjetik.

- Etapa pasmagmatike ose hidrotermale shprehet sidomos në formimin e sulfureve (pirotine, pirit, petlandit etj.) dhe i disa mineraleve jo metalore (klorit, kalcit, epidot etj.) Në këto mes duhet futur dhe procesi autometamorfik dhe alometamorfik i serpentinitizimit, asbestizimit, magnetitizimit, që shprehen me tepër në zonën e Qerretit.

Se fundi në natyrën gjeologjike-mineralogjike të mineralizimit të hekur-titanit ndikon etapa e tjetërsimit, hipergjeneza, që shfaqet me formimin e hidroksideve të hekurit, me leukoksenizimin e mineraleve titanifere, kaolinizimin e plagioklazit etj.

PERFUNDIME

1. Brezi ofiolitik perendimor i Albanideve ne sektorin me te zhvilluar te tij, ne ate verior, ndertohet nga kompleksi plutonogjen i perbere nga sekuenca mantelike ultrabazike si mase zoteruese, dhe ne vazhdimesim jo kudo, nga sekuenca kumulate ultrabazike-bazike, seria shkembore gabrogabrodiabaze, seria shkembore damarore dhe kompleksi vullkanogjen i lavave jastekore bazike.

2. Sekuenca kumulative ultrabazike-bazike paraqet interes te veçante petrologjik e metalogjenik per mineralizimin e hekur-titanit.

3. Mineralizimi i hekur-titanit zhvillohet ne tre formacione xeherore: magnetitik, magnetito-ilmenitik vanadmbajtes dhe titanomagnetit vanadmbajtes. Formacioni magnetik zhvillohet kryesisht ne zonen kalimtare ultrabazike-bazike, me perfaqesim me te plote ne zonen e Qerretit. Formacioni magnetit-ilmenitik vanadmbajtes lidhet kryesisht me shkembinjte gabrore (ferrogabrot) te masiveve te vegjel gabroperidotite. Perfaqesimin me te plote e ka ne zonen e Kashnjetit. Formacioni titanomagnetitik vanadmbajtes lidhet me teper me serine shkembore gabrogabrodiabazike, me perfaqesim me te plote ne zonen e Kashnjetit.

4. Te dhenat morfologjike, strukturore e kimike percaktojne formimin e mineralizimit hekur-titan ne temperaturat 700-400°, gje qe saktosohet nga trajtat rrjetore pllakore, kafazore, te tipit te pertiteve e mirmekiteve midis magnetitit, ilmenitit, ulvoshpinelit.

5. Mineralizimi i hekur-titanit te brezit ofiolitik perendimor te Albanideve eshte formim tipik magmatik i lidhur ngushte me formimin e konsolidimit e mases silikate shkembore, gjate diferencimit e kristalizimit gravitativ. Vende-vende ne proceset mineralformuese eshte zhvilluar ne menyre te pjeseshme dhe diferencimi per likuacionin qe shfaqet me pranine e mineralizimeve shoqerues sulfure.

6. Ne zonat e mineralizuara mund te veçohen disa etapa mineralizimi si magmatike e vertete, intramagmatike, pasmagmatike hidrotermale, dhe hipergjene siperfaqesore.

LITERATURA

- Çaku Q., Teršana A., Gucia B., 1976 - Permbledhje Studimesh, Nr. 2, Tirane.
- Çina A., 1985 - Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4, Tirane.
- Çina A., Tashko A., Teršana A., 1987 - The Bulqiza and Gomsiqë ultrabasic massifs: Ophiolites of Albanides: A Geochemical comparison. Ofioliti 12 (1): 219-236.
- Gjata K., 1980 - Petrologjia dhe perspektiva e nikelit sulfur dhe sulfureve te tjere te kompleksit gabro-peridotit te Mirdites perendimore. Disertacion, Tirane.
- Ghose N.G., 1980 - Magnetite deposit in the ophiolite belt of Noga Hills NE Indis. Ofioliti 5/1: 126-130.
- Kaltani A., 1979 - Rruget e perdorura per pasurimin e xeheroreve hekurore te tipit magnetit-titanomagnetit. Disertacion, Tirane. Godishnik, Tom 28, Sofija; 19-29.
- Kati P., 1986 - Bul. shk. Gjeol. Nr. 2, Tirane.
- Serri G. and Saitta M., 1980 - Fractionation trend of the gabbroic complexes from high - Ti low-Ti ophiolites and the crust of major oceanic basins: a comparison. Ofioliti, 5: 241-264.
- Shallo M., Kote Dh., Vranaj A., Premti I., 1989 - Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2, Tirane.
- Tashko A., 1985 - Bul. Sh.Gj. Nr.3, Tirane.
- Teršana A., 1982 - Bul. Shk. Gjeol., Nr. Tirane
- Teršana A., 1982 - Petrologjia dhe metalogjenia e kompleksit gabroperidotit e rajonit Kashnjet. Disertacion, Tirane.
- Teršana A., 1986 - Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4, Tirane.
- Thanasi A., 1983 - Studim mbi metodat e analizave komplekse te xeherorit te titanit dhe vleresimi kimik i titanomagnetitit te Kashnjetit e disa shfaqjeve te tjera. Disertacion. Tirane.

Redaktor: Prof. Dr. Afat SERJANI

RESUME

Dans l'article ci-présent on a essayé d'aborder le problème de la minéralisation du fer-titano-vanadite localisée dans la ceinture ophiolitique de l'ouest des Albanides. Cette ceinture rocheuse dans sa partie plus évoluée (celle septentrionale), comporte du bas en haut:

- le complexe plutonique représenté par: la séquence mantelique ultrabasique; la séquence de cumulates ultrabasique-basique; la série rocheuse gabro-gabrodiabase; la série rocheuse filonienne.

-le complexe volcanogène du type pilowlava.

La minéralisation se développe en trois formations de minerais:

formation de magnetite (zone de Qerreti); formation magnetit-ilmenitique avec du vanadium (zone de Kashnjeti); formation de titanomagnetite avec du vanadium (zone de Kacinari).

La première formation se développe essentiellement dans la bande rocheuse de passage ultrabasique-basique, la deuxième dans série des gabbros (ferrogabbro) et la troisième s'attache la base rocheuse gabro-gabbro-diabasique. Le même type de minéralisation peut être observé dans la série filonienne basique et moyenne. Dans tous les cas, la minéralisation est pauvre. Dans la zone de Kashnjeti, la minéralisation de la concentration de magnetites riche en vanadium.

Cette minéralisation est un phénomène typique magmatique, lié étroitement à la formation et à la consolidation de la masse rocheuse silicate au cours de la différenciation et de la cristallisation gravitative. Il y a des éléments de la phase de liquation et hydrothermale qui s'expriment par la minéralisation des sulfures.

KERKIM I METEJSHEM I ARIT NE SHQIPERI

Mehmet Zaçaj, Keshilli i Ministrave, Tirane.

Ne Shqipëri ari është kerkuar e vlerësuar në dy rruget e njohura, si element shoqerues në vb. sulfure por edhe si mineralizime thjeshtë ari. Synimi në këtë artikull është që të sugjerojmë disa drejtime për kerkimin e metejsheëm të tij në Shqipëri.

TIPET KRYESORE TE VENDBURIMEVE TE ARIT NE BOTE DHE PERFAQESIMI I TYRE NE VENDIN TONE

Në literaturën shkencore gjeologjike jepen klasifikime të shumta të vendburimeve të ari nisur nga kritere gjenetike, të perberjes, të bashkeshoqerimeve gjeokimike e mineralogjike, të temperaturës e të thellesisë së formimit etj. Për synimin që kemi në këtë artikull në gjykojmë se me i drejte do të ishte një klasifikim i cili merret parasysh kombinimin e të tere faktorëve. Në këtë mënyrë dallohen lehtë dy grupe kryesore e të medha vendburimesh prej të cilëve nxirret ari.

A. Vendburime të polisulfureve armbajtëse, ku ari ndodhet e shfrytëzohet si element shoqerues.

Vendburimet e polisulfureve armbajtëse nga pikepamja gjenetike mund të ndahen në 3 tipe kryesore:

I. *Tipi i vendburimit magmatike të Cu-Ni me petllandit* me përmbajtje të ulet ari, argjendi, e platini shoqerues. Përmbajtja e ari në vb. luhetet në disa të dhjetat e gr/ton. Ky tip lidhet me shkëmbinjte bazike e ultrabazike.

II. *Tipi i vendburimit të bakrit dhe të plumb-zinkut të kontaktit metasomatik*; përmbajtja e ari luhetet nga 0, n gr./ton deri në n gr./ton.

III. *Tipi i vb hidrotermale të Cu, Pb - Zn, piriteve*, i cili për vendin tone paraqet rendesi. Sipas përberjes mineralogjike, të temperaturës e të thellesisë së formimit në këtë tip dallohen disa formacione:

1. *Formacioni i vb polimetalore të temperaturës së lartë* i cili lidhet me masivet granitoide (batolitike), për vendin tone nuk paraqet interes.

2. *Formacioni i vb polimetalore të temperaturës së mesme dhe të ulet* me të cilin në vendin tone lidhen vb sulfure e armbajtëse vullkanike polime-

talore ne Qaf Bari, Munelle, Gurth, Spaç, Perlat, Rrenjolle, Kaçinar, etj. vb. te tipit damaror, lentor-damaror (kollçedan) e metasomatik. Ari dhe argjendi perfitohen krahas elementeve kryesore Cu, S, Zn etj. Ky tip lidhet gjenetikiisht me formacionin vullkanogjen te perberjes bazike deri ne mesataro-acide.

3. Formacioni i vendburimit kollçedane te bakrit, eshte teper i njohur ne vendin tone dhe ne te gjitha llojet e vb te tij kollçedane te bakrit, kollçedane piritoze, krahas elementeve te tjere shoqerues permbahet edhe ari ne kufijte nga gjurme deri ne disa gr./ton. Ne kete formacion perfshihen vendburime sulfurore vullkano-sedimentare te bakrit etj. si Rubiku, Qaf Kingiel, Palaj, Karme, Porave, Gjegjan etj.

4. Formacioni i vb damarore te bakrit eshte gjeresisht i i perhapur ne vendin tone me vb e shfaqje damarore kuarc sulfurore si Kurbneshi, Golaj, Nikoliq, Thirre, Shemeri, Gdheshte, Tuçi Lindor, Kçire, Krume, etj. te cilet gjenetikiisht lidhen me formacionin plutogjen gabro-plagjiogranitik.

B. Vendburime te arit

VB. hidrotermale te arit formohen ne intervale te gjera thellesie e ne temperatura nga te larta deri ne ato te ulta. Sipas temperatures se formimit dhe tipit te xeherorit veçohen:

I. Tipi i vb te damareve te kuarcit me ar te temperaturave te larta deri ne te mesme i cili gjenetikiisht lidhet me masivet e medhenj granitike dhe per vendin tone nuk paraqet interes.

II. Tipi i vb hidrotermale te damareve te kuarcit me ar te temperaturave te mesme deri ne te ulta i cili lidhet me masive te vegjel te ashtuquajtur intruzione te vogla te perberjes acide e mesataro-acide, me shkembinj vullkanike te perberjes kryesisht mesatare dhe fazen dajkore. Ne perberje te ketij tipi veçohen keto formacione armbajtese:

1. Formacioni i damareve te kuarcit pa ose deri ne 5 % sulfure. Ari eshte kryesisht i lire dhe kokerr imet. Ne vendin tone ketij formacioni i perkasin damaret e kuarcit te kodrave te Rrenjolles, damaret e kuarcit ne Sholt te Fundit te Vogel nder gabronorite, ne Skacaj te Shemrise (Kukes) ne kuarcdiorite, ne M. e Megules nder gabro, ne Llange, ne Shank nder gabro, ne Ndershene nder kuarcdiorite etj.

2. Formacioni i damareve te kuarcit me ar me deri 20 % sulfure. Me rritjen e metejshme te sulfureve keto vendburime kalojne ne grupin e vendburimeve sulfure armbajtese. Shpesh here takohen jo vetem ne trajten e damareve kuarcore me sulfure, por edhe te zonave te kuarcezuara e sulfurizuara ne trajte shtratimesh ose shtokverkesh me gjeneze hidrotermale-

metasomatike e shfaqje te kuarcit sekondar duke u karakterizuar nga ndryshime anesore hidrotermale shume te zhvilluara.

Ne vendin tone me kete formacion lidhet vendburimi i arit i Gjazujve nder vullkanite, mineralizimet e arit ne Grene ne gabro-diabaze, mineralizimet e arit ne Shengjergj ne vullkanite si dhe nje sere mineralizimesh te tjera ne trajte te damareve e te zonave te mineralizuara ne rajonin e vb. Thirre, ne masivin gabror te Bulsharit, zonat e tektonizuara e te piritizuara me deje e damare kuarci, te ashtuquajturat zona te mineralizuara te Lekundes, te Shebes, te Qaf Kishes, te Kthelles, te Repeshkut nder vullkanite, zonat e piritizuara e te kloritizuara me deje e damare kuarci ne gabro, ne kuarcdiorite dhe ne kontaktin ndermjet shkembinjve vullkanike e plutogjene(3).

3. Formacioni i damareve te kuarcit dhe kuarc-karbonateve me ar i temperaturave te uleta (teletermale) me selenide e teluride te arit. Roli i ketyre vendburimeve, kohet e fundit eshte gjithnje ne rritje ne prodhimin boteror te arit. Gjenetikiisht keto vendburime lidhen kryesisht me vullkanitet tercjare te perberjes mesataro-acide me theks alkaliner. Ne vendin tone nuk kemi ende dukuri te ketij mineralizimi.

III. Tipi i vendburimeve te zonave te kuarcezuara e piritizuara me ar. Formohet ne temperatura te mesme deri ne te uleta dhe gjenetikiisht lidhet po me ate magmatizem si edhe tipi i dyte. Ne kete rast, mineralizimi shfaqet jo ne trajte damarash kuarcore por zonash te kuarcezuara me formime te mikrokuarciteve te impenjuara me sulfure. Karakteristike jane rezervat e medha xeherore me permbajtje te uleta te arit. Ky tip vendburimi mund te kerkohet e gjendet edhe ne vendin tone, por kerkon velleme te shumta punimesh per vleresimin e armbajtje.

IV. Tipi i vendburimeve te arit ne Listvenite (ne ultrabazike te karbonatizuar).

Shembujt e vendburimeve te arit ne listvenite jane studiuar e zbuluar ne Alpe, Arabi e Marok etj. Mendohet se koncentrimi i arit ne listvenite eshte i lidhur me sulfuret e pasura me Au, me sulfoarsenide ose arsenide te pasura me Au, duke pranuar nje transport te Au nga komplekset sulfurore ose arsenikale ne sistemet hidrotermale. Per te shpjeguar shplarjen e Au dhe transportin e tij, eshte supozuar nje model i sistemeve hidrotermale regjionale te cilet qarkullojne neper te gjitha volumin kolosal te shkembinjve ultrabazike gjate stadeve te fundit te vendosjes se tyre tektonike dhe serpentinizimit. Kontaktet tektonike kane qene rruget kanale per ujrart detare te nxehta te pasura me CO₂-Ca-S qe linden procesin e karbonatizimit. Karbonatet, siliciumi, sulfuret, arsenidet dhe ari u akumuluan ne te njejtin vend nga mekanizma te ndryshme

me evolimin e sistemit hidrotermal. Solucionet acide armbajtese precipituan arsenidet-piritin-silicium dhe arin kur hyne ne ambientin alkaline e reduktues te shkembinjve te karbonatizuar.

C. Vendburimet metamorfogjene

Perfaqesuesit kryesor te ketij tipi jane konglomeratet armbajtese te moshes se parakembrit dhe ari gjendet ne çimenton e tyre ne trajte te imet dispersive me permbajtje nga 1 gr/ton deri ne 5-6 gr./ton, japin rreth 40 % te prodhimit boteror te arit. Ne 15-20 vitet e fundit ne bote po studjohet edhe armbajtja e konglomerateve ne mosha te reja, pak ose te pametamorfizuara.

D. Shkriferimet aluviale te arit

Rezervat kryesore te arit ne shkriferimet aluviale perqendrohen ne luginat dhe shtratet e lumenjve te sotem ose te vjeter, me permbajtje nga disa miligram deri ne disa gr. per m³.

HIPOTEZAT MBI SHPERNDARJEN REGJIONALE TE ARIT

Sipas studiuvesve te ndryshem (1) diferencat regjionale te shperndarjes se arit ne llojet shkembore mafike e ultramafike i atribuohen diferencave primare per shkak te koncentrimet heterogjen te arit ne mantelin e siperm; diferencave ne zhvillimin e kores dhe diferencimin e mantelit si edhe ndryshimeve te shkaktuara nga proceset hidrotermale e metamorfike te cilat kane ndikuar modelet paresore te shperndarjes se arit. Mjaft te dhena tregojne se mineralet sulfure permbajne koncentrimet shume te larta ari, çka tregon se karakteri kalkofil i arit, eshte me i madh se ai litofil. Dy jane mendimet lidhur me diferencat ne shperndarjen regjionale te arit; *I pari*, i cili supozon se variacionet ne shperndarjen e arit shpjegohen me heterogjenitetin e arit ne mantelin e siperm dhe *i dyti*, i cili diferencat ne shperndarjen e arit i shpjegon si rrjedhim i rishperndarjes metamorfike- hidro-termale te arit. Nga analiza e fakteve studiuvesit arrijne ne perfundime qe tejshtypja metamorfike eshte faktor kryesor qe kontrollon formimin e damareve aurifere plus edhe prania e kurtheve te pershtateshme te lokalizimit.

KERKIMI I METEJSHEM I ARIT NE SHQIPERI

Me poshte ne menyre te permbledhur do te paraqesim disa mendime lidhur me zhvillimin e metejsheem te kerkimit te arit ne Shqiperi:

1. Tipi i vendburimeve hidrotermale sulfurore te Cu, Pb-Zn, piriteve armbajtese te njohura e zbuluara ne vendin tone. Nga studimi i raporteve gjeologjike tyre kerkim-zbulimit te vendburimeve e te shfaqjeve sulfurore (5) rezulton qe ari takohet pothuaj ne te gjithë formacionet e nenformacionet xeherore te kolones se shkembinjve vullkanogjene e plutonogjene te kompleksit ofiolitik. Megjithate konstatohet se:

1. Nuk eshte bere ndonje studim i orientuar e i plote per vleresimin gjeologo-ekonomik te armbajtjes se vb. sulfure vullkano-plutogjene.

2. Te dhenat e deritanishme per vleresimin e armbajtjes se ketyre mineralizimeve nuk jane kudo ne te njejtin nivel studiueshmerie.

3. Ka te dhena qe krahas formacioneve xeherore ari eshte prezent deri nr 1 gr./ton e me shume edhe ne zonat e ndryshimeve hidrotermale anesore, te cilat mbeshtjellin trupat xeherore ose jane larg tyre, te varfera ne elementet kryesore (vb. Perlat etj.). Por keto zona nuk jane vleresuar per armbajtje.

4. Te dhenat e shumta tregojne se ari ne mineralizimet sulfure ka shperndarje teper heterogjene brenda trupit xeheror, nga njeri trup tek tjetri, prandaj kerkohen studime sistematike e te orjentuara te trupave xeheror.

5. Nga studimet e pasurimit te xeheroreve sulfure polimetalor (sepse studime pasurimi vetem per arin nuk jane bere) rezulton (5) se ne xeheroret e vb Munelle te tipit pirit-kalkopirit masiv gjate pasurimit pjesa me e madhe e arit shkon ne sterile me rikuperim mjaft te ulet 6.14 %, ne xeheroret e vendburimit Gurth gjate pasurimit me nxjerrje selektive te koncentrateve 87 % e arit kalon ne koncentratin e Cu-Zn, 6 % ne koncentratin e piritit dhe 6 % ne sterile, ne vb e Perlatit ka 2.1 gr./ton ar ne koncentratin e bakrit me rikuperim 17 % etj çka nxjerr ne pah shkallen e perfitimit te arit.

Si perfundim:

1. Tipi i vendburimeve sulfurore armbajtese mbetet objekt kryesor i kerkimit edhe per te arthmen ne Shqiperi, kerkohet medoemos edhe vleresimi ekonomik i arit krahas Cu, Zn S. Per kete eshte e arsyeshme qe te punohet ne te dy drejtimet, si per rivleresimin e vendburimeve te zbuluara deri tani nepermjet perpunimit te te dhenave te grumbulluara nga punimet e shumta te kerkim-zbulimit ashtu edhe per vleresimin e vendburimeve te reja.

2. Tipi i vendburimeve hidrotermale te damareve te kuarcit me ar te temperaturave te mesme deri ne te ulta. Sikurse permendem edhe me lart shfaqje e grumbullime mineralizimesh armbajtese te ketij tipi jane evidentuar e zbuluar edhe ne vendin tone. Nese deri tani nuk jane zbuluar vendburimet ekonomike te ketij tipi kjo eshte ndikuar nga fakti qe pervoja e jone ka qene e

paket dhe financimet per te aplikuar metoda, metodika e teknika perpunimi e analizimi te kohes kane qene fare simbolike. Por te dhenat e shumta qe disponon sherbimi gjeologjik per armbajtjen e ketij tipi ne vendin tone me mundesi te reja financiare meritojne te rivleresohen e te ripunohen per te selskionuar e zgjedhur zonat me te pershtateshme per kerkimin e metejshem te ketij tipi mineralizimi armbajtes.

3. Nga literatura gjeologjike shkencore (1) rezulton se vendburimet armbajtese jane tipike per moshat e vjetra gjeologjike. Per rjedhim fakti qe zonat e Gashit e te Korabit ne Shqiperi jane vazhdimi i atyre te ish Jugosllavise ne te cilat jane zbuluar vendburime te rendesishme ari e argjendi, prania ne zonat tona e damareve te kuarcit po ose me sulfure, e mineralizimeve sulfure me arsenik, Pb + Zn etj. ne Radomire, Shistavec, Rupe, e zonave te ndrydhura tektonike te kiarcezuarat te piritizuara, here here edhe te kloritizuara; e shenjave te arit ne shlihot e zones se Gashit e te Korabit (3); e shenjave te arit ne shlihot artificiale te kuarciteve te Shistavecit tregojne qe perspektiva armbajtese (si per vendburimet thjeshte te arit ashtu edhe per ato sulfurore armbajtese) e formacioneve te vjetra ne Shqiperi duhet pare me gjere e me me interes ne te arthmen.

4. Vendburimet e arit ne listvenite. Ne vendin tone listvenite jane pershkruar nga I. Premti, 1974 si ambjent i lokalizimit te mineralizimeve te arsenikut ne rajonin e Peshkopise, por armbajtjen e tyre. Atehere vemendja duhet perqendruar se pari ne evidentimin e perhapjes se shkembinjve serpentinite dhe sy dyti ne fusheperhapjen e tyre duhet te terheqin vemendjen a) sektoret me permbajtje 0.02 ppm deri 1 ppm Au (10 - 100 here me te rritura se sa vlerat qe tipizojne vete shkembinjte ultrabazike qe rrethojne linzat listvenite) dhe b). sektoret e pasur me pirit (10-50 ppm Au), Co-As (10-100 ppm.Au) e damare kuarcore te vonshem (0.2-10 ppm.) me pirit ose arsenopirit

5. Kohe me pare ne Çerave eshte vene ne perdorim nje impjant i thjeshte per shfrytezimin e shkriferimit aluvial per materialet inerte, lenden kuarcore dhe jane perfutuar edhe disa dhjetra ton koncentrat i rende me ar (i cili me tej eshte perpunuar ne impiantin e Rashbullit ne Durres e ne uzinen e shkrirjes ne Rubik). Me nje bilanc ekonomik te shpenzimeve qe kerkohen e te fitimit qe realizohet kjo mbetet nje mundesi reale per shfrytezimin e tyre.

6. Konglomeratet e moshave te vjetra e te reja ne vendin tone jane te pa studjuara per armbajtje. Prania e tyre ne zonen e Korabit e te Gashit, ne gropat e brendeshme ashtu edhe ne zonat e jashteme le te hapur rrugen per vleresimin e mundesise se armbajtjes se tyre.

7. Disa veçori te kerkimit te arit. Zbulimet e medha te 10-15 viteve te fundit te vendburimeve te arit e te argjendit ne rajonin e Paqesorit ka ne dhene pervoje interesante ne kerkimin e mineralizimeve te arit.

- Sipas studjuesve teknika e kerkimit fillon me pervijejimin e siperfaqes se shkembinjve mesatare deri acide nepermjet perdorimit te satelitit e te rilevimit ajror dhe me tej perdorimi i gjeokimise se sedimenteve te rjedhjes, i rilevimeve gjeobotanike, i metodave gjeofizike etj. sherbejne per detalizimin e metejshem te siperfaqeve arifere.

- Per kerkimin e arit kryhen ne stil te gjere edhe studimet mineralogjike. Nga studimet e shume vendburimeve te ndryshme (1) bie ne sy roli i ketyre studimeve ne aspektin teorik plotesues por dhe ne aspektin praktik duke i perdorur bashkeshoqerimet mineralogjike si kritere kerkimi.

- Transporti dhe precipitimi i arit. Gjate kerkimit te arit kryhen edhe nje sere studimesh per transportin hidrotermal e hidraulik te lendes minerale e te solucioneve mineralizatore, te cilat synojne e japin spjegime per kushtet e rrethanat fizike e kimike te formimit, te transportit e te precipitimit te arit e te mineraleve shoqerues te tij.

L I T E R A T U R A

1. "Gold in Europe - 98" International Symposium in Europe on Gold metallogeny, exploration and beneficiation. Toulouse, France, 23-25 May 1989. Biblioteka e ISPGJ Tirane.
2. Bache J. Les gisements L'ar dans le monde. Memorie BRGM nr.18. Orleans, 1982 ISPGJ Tirane, biblioteka.
3. Buda V. Studim mbi burimet meme primare te arit ne RPSH 1967. FQJ, Tirane.
4. Zaçaj M, Buda V, Deda T. - Gjendja dhe zhvillimi i metejshem i kerkimeve te arit ne Shqiperi. Fondi i ISPGJ Tirane, 1989.
5. Zaçaj M, Qirici V. - Studim tematiko-pergjithesues mbi gjetjen e rrugeve per vleresimin gjeologo-ekonomik te armbajtjes te venibuimeve sulfure vullkanogjene te Mirdites Qendrore. Projekt, 1989. Fondi i ISPGJ Tirane.
6. Necati Tuysuz. - Listwaenites, a new target in gold explorations, 1990 MTA, Ankara.
7. Ion Popovici - L'or en Roumanie. Toulouse, 25 May 1989.

Redaktor: Prof. Dr. Besnik OSTROSI

SUMMARY

FURTHER RESEARCH OF GOLD IN ALBANIA

The gold was researched and exploited in Albania. In this article, seeing the world experience in this field are given some conclusions and directions to develop the gold's researches in Albania hereafter.

1. Copper deposits, Copper-pyrite, Copper-pyrite-zinc, Copper-zinc deposits with gold associated with ophiolite complex rocks (volcanic, volcano-sedimentary and plutonic) will be the essential spring of reserves of gold in Albania hereafter.

2. There are many data of mineralisation of goldbearing vein in Albania. In this group are included the quartz goldbearing vein of Gjazuj, Shengjergj, Fregen; some occurrences of quartz - carbonatic goldbearing veins and some quartz veins, tectonic zones with gold, with or without sulfures. Vein's formations there are epigenetic therefore are found in all section of the jurasic ophiolitic complex in the ultrabasic, gabro, quartz - diorite, plagiogranits and in volcanics. When there are present sulfures (pyrite, chalcopyrite, sphalerite etc.) the gold is as their association. So think that the first must elaborate data to selected appropriate zones for further researches.

3. The polisulfure goldbearing deposits in many countries of the world belongs to the old age formations. In the Gashi and Korabi zones are founded too quartz veins without or with sulfures; sulfure mineralisations with As, Pb + Zn etc. at Radomira, Shistavec etc; which are ore important guides for these deposits in these zones.

4. Gold deposits in listwaenite (carbonated ultrabasic rocks). This type deposits is less known in the world. But last years there are discovered gold deposits in Alps, Arabian, Marocco etc. The wide spread field of the ultrabasic rocks in Albania there is one important ore guide. In Albania were found arsenic occurrences in listwaenites, by Premti I. (1971) in the Peshkopia region, which must proved for goldbearing, and in framework of geological mapping must found listwanite rocks.

5. Conglomerates of old and new ages which in our country there are not studied for goldbearing. But their presence in the Gashi and Korabi zones, in the inner and extern depressions too ask the evaluation of their goldbearing.

ARGJILAT INDUSTRIALE TE SHENGJUNIT TE MATIT, GJEOLGJIA DHE KUSHTET E FORMIMIT TE TYRE

Ylber Muceku, Ndermarrja Gjeologjike Burrel

Stavri Burri, Fakulteti i Gjeologjise dhe Minierave, Universiteti Politeknik, Tirane

Paraqiten te dhena te pergjithshme mbi ndodhjen e argjilave industriale montmorilonito-atapulгите te vendburimit te Shengjunit ne rrethin e Matit. Jepet ndertimi gjeologjik i rajonit ku shtrihen keto argjila, karakteristikat e prerjes gjeologjike dhe te kushteve te formimit te tyre ne sfondin e formimit te gropes se brendshme paramalore te Burrelit.

I. NDERTIMI GJEOLGJIK I RAJONIT

Rajoni ku ndodhet vendburimi i argjilave montmorillonito-atapulгите Shengjun, ben pjese ne njesine tektonike Mirdita dhe vendoset ne anen perendimore te masivit ultrabazik te Bulqizes, atje ku nis e ashtuquajtura perkulja ndermalore, ose grupa e Burrelit e mbushur me depozitime te reja molasike. Ne kete rajon marrin pjese formimet e meposhtme:

- a. Shkembinjte magmatike te masivit ultrabazik te Bulqizes ($J_{2,3}$);
- b. Korja e tjetersimit lateritik;
- c. Formimet neogjenike Tortoniane (N_{1t_1});
- d. Depozitimet e Kretes se poshtme (Cr_1);
- e. Depozitimet kuaternare (Q_4).

1. Shkembinjte ultrabazike

Shkembinjte ultrabazike perfaqesohen nga pjesa perendimore e masivit te Bulqizes dhe zene pjesen lindore dhe me pak perendimore te rajonit ne te cilin shtrihet vendburimi i argjilave montmorilonito-atapulгите Shengjun.

Karakteristike per kete mase ultrabazike eshte paraqitja shume e ndryshuar nga veprimtaria tektonike, ku formohen zona te tera te coptuara dhe

te millonitizuara. Karakteristike tjeter e ketij rajoni eshte nderprerja nga nje seri damarore leukokrate shkembinjsh bazike deri acide-granitike qe perben ne vetvete nje specifike gjeologo-petrografike me interesa per studime te metejsme. Nder ta shquhet nje damar graniti biotitik, leukokrat, kokrize madh me gjeresi 2-3 m, i cili pershkron shkembinjte shume te serpentinizuar sipas orjentimit V-J me dalje te qarta ne siperfaqe. Po keshtu zhvillimi i dukshem imineralizimit hidrotermal te magnezitit ne trajte damaresh te bardhe qe kane mjaft dalje siperfaqesore.

2. Shkembinjte sedimentare

Zene pjesen qendrore, veriore dhe perendimore te rajonit ku ndodhet vendburimi i argjilave montmorilonite-atapulгите Shengjun.

Ne kompleksin e shkembinjve sedimentare dallohen:

- Depozitimet e Kretakut te poshtem ;
- Produktet e kores se tjetersimit lateritik;
- Depozitimet molasike te Tortonianit;
- Depozitimet kuaternare.

a) Depozitimet e Kretakut te poshtem (Cr_1)

Keto depozitime vendosen transgresivisht mbi shkembinjte ultrabazike dhe perhapen ne pjesen jugperendimore e me pak ne qender te rajonit ku shtrihet vendburimi i argjilave. Perfaqesohen nga konglobrekciet ofiolitike qe ndonjehere permbajne dhe ndershtresa silicoresh te bardhe e te kuq.

b) Produktet e kores se tjetersimit lateritik

Korja e tjetersimit te shkembinjve ultrabazike ka zhvillim relativisht te kufizuar ne rajon. Shfaqjet kryesore te saj jane: Perroi i Licit, Perroi i Stalles, Perroi i Canit, Perroi i Fujzes dhe Perroi i degezimit Stalles. Prerja gjeologjike e kores ne keto shfaqje perbehet prej dy shtresash ose nenshtresash, ajo e brekcieve ultrabazike dhe shtresa e argjilave.

Shtresa e brekcieve ultrabazike paraqitet me teper si mase e coptuar, jo kompakte dhe e cimentuar dobet. Jane shume te serpentinizuara, te karbona-




Fig.1. Harta gjeologjike skematike e vendburimeve te argjilave montmorilonite-atapulгите te Shengjunit (The Geological Schematic Map of Montmorilonite-Atapulgit Clay Deposits in Shengjun)

tizuara dhe te limonitizuara. Trashesia e kesaj shtrese eshte 1-2 m deri ne 10 m, gjithmone e vendosur dhe zhvilluar transgresivisht mbi serpentinitet e ndryshuara. Shtresa e argjilave vendoset mbi shtresen e brekcieve ultrabazike me cimentim te dobet ose ka raste qe vendoset dhe ne vend te tyre. Ka ngjyre te kuqeremte, roze te bardhe, me nje ndertim masiv ose dheror dhe vende-vende paraqitet poroze me mbetje te copave te serpentinave jeshile te gabrove dhe magnezitit te bardhe.

Kjo eshte nje argjile jo e njetrajtshme por me njolla karbonate, agregate silicore e serpentine te shperbere, mjaft e perlyer me hidrokside hekuri, qe te kujton shtresen "nontronitike" te kores se tjetersimit lateritik ku permbajtja e NiO leviz nga 0,3-0,4 %.

c) Depozitimet molasike te Tortonianit (N_{1t2})

Perhapen ne veri dhe perendim te rajonit. Vendosen transgresivisht mbi shkembinjte ofiolitike ultrabazike. perfaqesohen nga trashesi te fuqishme 50-100 m konglomeratesh , ku ne pjeset me te siperme nderthuren me shtresa ranoresh dhe alevrolitesh.

d) Depozitimet kuaternare (Q_4)

Keto depozitime zene pjesen me te madhe te rajonit, te cilat fshehin daljen e shtreses argjilore, po ashtu dhe daljet rrenjesore te shkembinjve te tjere magmatike ose sedimentare te permendur me lart.

Prerfaqesojne prodhime trashamane te shkaterimit fizik te shkembinjve ultrabazike e me pak bazike te cilat japin mbulesen deluaviale, proluviale, brekciat e shpatit, depozitimet kenetore-liqenore, mbulesen dherore-vegjetale.

II. KARAKTERISTIKAT GJEOLOGJIKE TE VENDBURIMIT TE ARGJILAVE MONTMORILLONITE-ATTAPULGITE SHENGJUN

Vendburimi i argjilave te Shengjunit perbehet nga disa objekte dhe shfaqje te mineralizuara qe dalin dhe zhvillohen sipas shpateve te perrenjve qe pershkojne rajonin. Prandaj dhe objektet dhe shfaqjet jane emeruar sipas emrit te perrenjve : Objekti Perroi Licet, shfaqja Perroi Fujzes, shfaqja Perroi Canit,



Fig. 2.

shfaqja e degezimit Perroi Stalles, Objekti Perroi Stalles, te cilet te marra se bashku perfaqesojne nje shtrese argjilore, jo te rregullt monklinale, me shtrirje 330° - 360° , me renie te vogel drejt perendimit (nga horizontal deri $8-10^{\circ}$), me gjatesi sipas shtrirjes 1,2 km (nga Objekti Perroi Licet deri tek Objekti Perroi

Stalles), me gjeresi sipas renies nga 80-100 m (Shfaqja Perroi Canit) deri 240-250 m (Objekti Perroi Licit). Ne vendburimin e argjilave Shengjun "Objekti Perroi i Licit" ze pjesen veriore te tij dhe perben njekohesisht dhe daljen kryesore te tij (Fig.1).

Argjilat montmorilonito-atapulгите dalin ne siperfaqe sipas shpateve te Perroit te Licit me nje gjatesi 450 m, sipas rrjedhjes se Perroit. Nga punimet qe jane kryer, ka rezultuar ky profil gjeologjik nga poshte lart (Fig.2):

Ne pjesen me te poshtme te prerjes kemi shkembinte ultrabazike, te cilet perfaqesohen nga harzburgite me klinopiroksen qe jane shume te serpentinizuar te cilat ne pjesen me te siperme te tyre kalojne ne serpentinite me ngjyre te zeze. Mbi serpentinitet vendoset transgresivisht horizonti i brekceve ultrabazike te cilat paraqiten si masa te coptuara jo kompakte dhe te cimentuar dobet, shume te serpentinizuar, karbonatizuar e qe kane nje trashesi 1-2 m deri 8-10 m. Mbi kete horizont vendoset horizonti argjilmbajtes i cili paraqitet si vijon:

Ne pjesen me te poshtme, pra ne dysHEME te horizontit argjilmbajtes, ne kontakt me horizontin e brekceve ultrabazike kemi shtresen e argjilave me ngjyre kafe te erret te cilat permbajne mbetje serpentinitesh ne forme kokrizash te vogla 1-2 mm, por ndonjehere edhe me te medha, jane kompakte dhe kane nje trashesi 2-10 m. Siper kesaj shtrese vendoset shtresa e argjilave me ngjyre kafe te hapur, roze e hapur deri ne te bardhe qe paraqiten te alternuara ne vendosje here njera dhe here tjetra. Permbajne njolla te bardha magnezitesh e karbonatesh gjithashtu dhe mbetje serpentinas. Jane kompakte dhe kane trashesi 5-10 m. Akoma me siper ketij shtresEZIMI te alternuar njeri me tjetrin perseri vendosen argjilat me ngjyre kafe te erret, te cilat jane kompakte, permbajne shume pak mbetje ne forme njollash serpentinas. Kane trashesi 4-5 m. Mbi kete shtrese eshte vendosur shtresa e argjilave te bardha me pak nuanca jeshile dhe roze. Keto argjila kane veti shume te mira higroskopike, jane shume te lehta sepse kane ndertim poroz dhe kane nje trashesi 1-3 m.

Me lart, vendoset nje shtrese qe permban argjila ngjyre gri me shume copra ultrabazike me madhesi nga 1 deri ne 30 cm, e cila ka trashesi 1,8-2 m. Mbi kete shtrese vendoset shtresa e argjilave me ngjyre gri, shume me te lehta ne peshe me veti shume te mira higroskopike, qe kane ndertim fletezor dhe trashesi rreth 4 m.

Mbi keto argjila vendosen konglomeratet me zaje deri 1cm te perbere kryesisht nga shkembinj ultrabazike me me pak bazike, te perlyer me ngjyre te kuqe te hidroksideve te hekurit. lenda cimentuese perbehet nga argjila dhe alevroliti. Konglomeratet kane trashesi rreth 2 m. Ne mes te shtreses konglomerate kemi nje nderfute te nje shtrese argjilash me trashesi 0,5 m me ngjyre te kuqeremte shume te lehta ne peshe, me veti shume te mira higroskopike dhe me ndertim fletezor. Siper kesaj shtrese konglomeratike vendosen depozitimet e kuaternarit qe perfaqesohen nga deluvionet me trashesi 1 m deri 7-8 m.

Nje objekt tjetër i rendesishem i vendburimit te argjilave Shengjun eshte "Objekti Perroi Stalles" i cili ze pjesen me jugore te tij (Fig.1). Argjilat montmorillonite-atapulгите ne kete objekt dalin sipas shpateve te Perroit me nje gjatesi rreth 180 m. Ne kete objekt nga kryerja e punimeve ka rezultuar se kemi kete profil gjeologjik (Fig.2) nga poshte siper:

Pjesa me e poshtme e prerjes perbehet nga shkembinj ultrabazike te cilet perfaqesohen nga harzburgitet me klinopiroksen mesatarisht deri shume te serpentinizuar; pastaj mbi harzburgitet vendosen transgresivisht horizonti i brekcieve ultrabazike te cilat paraqiten si masa te coptuara jo kompakte dhe te cimentuar dobet. Jane shume te serpentinizuar, karbonatizuar dhe kane nje trashesi 0.5-1 m deri 10 m. Mbi kete horizont vendoset horizonti argjilmbajtes i cili ne kete objekt paraqitet si vijon:

Ne dysHEME te horizontit argjilmbajtes kemi shtresen e argjilave me ngjyre vishnje te erret te cilat jane kompakte, permbajne mbetje ne forme copash serpentinite me ngjyre jeshile. Ka trashesi 0.5-1 m deri 2-3 m. Siper kesaj shtrese vendoset shtresa e argjilave me ngjyre roze e mbyllur; kompakte, keto jane me te lehta ne peshe dhe kane veti te mira higroskopike ne krahasim me argjilat vishnje te erret. Edhe keto argjila permbajne mbetje ne forme kokrizash 1-2 mm deri 3 mm, nganjehere deri 1-2 cm te serpentinave me ngjyre jeshile. Kane trashesi 2-5 m. Mbi kete shtrese vendosen argjilat me ngjyre roze te hapur, kompakte, permbajne gjithashtu mbetje ne forme kokrizash serpentinitesh dhe njolla te bardha magneziti. Kane trashesi 2-4 m. Mbi kete shtrese vendosen argjilat me ngjyre kafe te erret, kafe te hapur deri ne bezhe. Argjilat e shtreses qe permendem me lart jane kompakte, me te lehta dhe kane veti me te mira se sa argjilat roze. Permbajne mbetje serpentinas ne forme kokrizash dhe njolla te bardha magneziti-kalciti. Trashesia e ketyre

eshte 2-3 m. Me siper akoma vjen shtresa e argjilave qe kane ngjyre kafe shume te hapur, roze shume e hapur, ngjyra keto qe shkojne deri te bardhe. Keto argjila jane shume te lehta dhe kane veti shume te mira higroskopike, kane ndertim poroz. Kjo shtrese ka nje trashesi 0.5-1 m deri ne 2,5 m dhe perben tavanin e horizontit argjilmbajtes. Horizonti argjilmbajtes mbulohet nga depozitimet e kuaternarit qe perfaqesohen nga deluvionet me trashesi nga 0.5-10 m.

III. KUSHTET GJEOLGJIKE TE FORMIMIT TE ARGJILAVE

Perhapja e prodhimeve te tjetersimit te kores lateritike ne masivin e Bulqizes eshte pasoje e proceseve te gjata e te vijueshme lateritikformuese e lateritikgrumbulluese qe kane shoqeruar zhvillimin gjeologjik te masivit qe ne periudhen jurasike, pas rrudhosjes alpine por qe jane zhvilluar me materiale te ndryshem ne pjese te vecanta te ofioliteve lindore. Keshtu ndersa ne verilindje, ne masivin e Kukesit keto procese shquhen per zhvillimin intensiv me formimin e xeherorit te nikelit dhe hekurit e me pak te boksitave, ne jug, ne Shebenik-Pogradec ato zhvillohen dukshem sidomos me xeherore te hekur-nikelit. Ne masivin e Bulqizes krijimi i penepenave te mirefillta e grumbullimet hekurore, me sa duket jane penguar si nga veprimtaria tektonike ashtu dhe ajo gerryese. Ketu gjate proceseve te serpentinizimit dhe lateritizimit te shkembinjve ultrabazike eshte liruar me shumice silica e cila duke hyre ne lidhje me mineralet e reja te formuara ne pjeset e siperme te kores tokesore ka formuar minerale argjilore me permbajtje te ndryshme silici. Mjedisi per zhvillimin e proceseve te tjetersimit lateritik ka qene deri diku i favorshem (llojet shkembore, struktura e tyre, kushtet klimaterike, geomorfologjia etj.) por me sa duket kushtet per grumbullimin e ruajtjen e tyre nuk kane qene te tilla, deri sa trashesia dhe perberja e kores ndryshon mjaft me ato te masiveve te tjere lindore.

Ne rajonin Shengjun-Bejne, duke u nisur nga perberja lendore dhe kimike e mineraleve kryesore qe takohen ne prodhimet paresore lateritike te mbetura ne vend ose disi te zhvendosura e te ridepozituara (lateritet dytesore) qe varet si nga formimi i tyre dhe nga zhvillimi i mevonshem, del se ata nuk mund te futen ne lateritet hekurore, nikelore, aluminore (boksitet, argjilat

boksitike) ose kaolinore (argjilat dhe argjilat kaolinore) sepse mungojne elemente te vecante ne sasi industriale si Fe, Ni, Co, ose mungon permbajtja e Al_2O_3 , Fe_2O_3 . Por ato bejne pjese ne formimet tipike pelitike, ne argjilat montmorilonite-ataulgite magneziale, qe jane me teper formime sedimentare liqenore. Sipas Patrik le Berre (1985), minerali attapulgit vjen si rezultat nga transformimi i smektiteve detritale ne nje abmjent lagunor nen ndikimin e tretesirave te pasura me magnezium. Duke u nisur nga perberja mineralogjike dhe kimike mund te mendohet se shkembinjte meme te shtreses argjilore kane qene shkembinjte ultrabazike me prirje bazike. Sipas literatures sedimentet kimike-bazike me attapulgit-sepiolite qe mund te jene liqenore, detare, mbikripore, zakonisht jane te perzjera e te lidhura me montmorillonitin si neformime silikatesh. Relacionet sedimentologjike midis attapulgit, sepiolitit dhe grupit te montmorillonitit perbejne nje problem sedimentologjik te vecante. Trashesia 10-12 m flet per nje periudhe te gjate tjetersimi ne kushte kontinentale. Kjo periudhe nis nga Tortoniani i poshtem (N_{1t1}) dhe vazhdon deri ne periudhat me te reja pliokuaternare. Ndryshimet e dukshme qe verehen ne prerjet lateritike te Shengjunit dhe ne shperndarjen e elementeve te dobishme ne vertikaltet, flasin per kushtet e paqendrueshme gjate periudhes gjeologjike shumeshekullore. Shtresa argjilore takohet ne siperfaqe si laterite te mbetura, te zbuluara ose te mbuluara nga depozitimet e kuaternarit.

LITERATURA

- Dir J.A, Haji R.A., Zusman J., 1966 - Porodoobrazujushe mineralij Vell.3.
 Duni S., Alabaku N., 1982 - Raporte gjeol. ne vb.e argjilave Shoshaj Burrel.
 Grazhdani A., 1967 - Studim mbi shkrikerimet e arit shtresor nga burimet sekondare te uletesires se Burrelit. Fondi Gjeologjise.
 Ihaos C.V., 1979 Attapulgit clays for future industrial Mineral Markets. Mining Inginnering. Vol22. No.12.
 Karaj N., Bicaj Z., 1986 - Relacion per rilevimin gjeologjik ne rajonin Shahinaj-Shengjun ne shkallen 1:1000
 Lefond S.L etc., 1975 - Industrial Minerals and rocks. New York.
 Muceku Y, Teršana A., etj., 1995 - Studim i vendburimit te argjilave Montmorillonite-Attapulgit te zones Shengjun-Bejne (klos-Mat).

- Onuzi K. Milushi I , 1989** - Studimi i punimeve ne shkallen 1:10000 ne rajonin Bater-Kraste-Bejne-Bulqize. Fondi Gjeologjise.
- Pashko P., 1967** - Mbi depozitimet neogj. te gropes se Burrelit. Bul.Shk.Nat.
- Pashko P., 1968** - Molusqet e suites Burrelit. Permb.Studimesh
- Tershana A., 1990** - Atapulgit ne koren e tjetersimit te shkemb.ultrab. te masivit te Bulqizes. Bul. Shk. Gjeol. Nr.3 Tirane.

Redaktor: Prof. Dr. Aleksander ÇINA

SUMMARY

THE INDUSTRIAL CLAY OF SHENGJUN (MAT), GEOLOGY AND THEIR CONDITIONS OF FORMATION

The geologic study of Shengjun zone, where is found for the first time Montmorillonit-Attapulgitite shows that there were the appropriate paleogeographical and sedimentological conditions for these kinds of formations. Ultrabasic and basic rocks of our country several times have passed through lathyrific transformation processes and they have given a bound material to form lathyrific products and clay material also. These products have given new characteristic production when they have found the appropriate conditions. This gives new perspectives to allow new researches in the inner depression for finding other clay occurrences which are more useful in different branches of industry. The practice values of this clays is better shown from a detailed mineralogical study.

MINERALIZIMET SEDIMENTARE TE Pb-Zn NE DEPOZITIMET TRIASIKE TE TREVES ALPINE DHE MUNDESIA E GJETJES SE TYRE NE SHQIPERINE E VERIUT (Rajoni i Shkodres)

Defrim Shkupi, Luftulla Peza, Instituti i Studimeve dhe Projekttimeve te Gjeologjise
Zef Bicaj, Mark Nikolla, Ndermarja Gjeologjike Shkoder

HYRJE

Per thellimin e studimeve gjeologjike, autoret ndermoren kete shkrim per te nxjerre ne drite problemin e mineralizimeve sedimentare te perqendruara kryesisht ne depozitimet karbonatike. Ne Shqiperine e veriut jane kryer shume punime e studime gjeologjike me karakter krahinor, stratigrafik dhe special per mineralizime te vecanta dhe jane dhene shtytje per kerkimin e tyre mineralizimeve (F.Bakalli etj., 1971). Duke u ballafquar me studimet e kryera me vone ne depozitimet ngjasore te Treves Alpine duke filluar nga Kordielierat Betike ne "Spanje" ne France, Zvicere, Austri, Itali e Jugosllavi veme re se kemi shume per te te bere per ta zgjidhur ne menyre optimale problemin e mineralizimeve sedimentare. Natyrisht nje pune e tille duhet te behet duke kordinuar studimet stratigrafike, sedimentologjike dhe kerkim-vleresuese per keto mineralizime. Mineralizimet sedimentare ne Treven Alpine ndeshen ne te gjitha depozitimet karbonatike duke filluar nga Permiani deri ne Kretak. Ne kete artikull do te shqyrtojme mineralizimet e lidhura me depozitimet triasike.

PERSHKRIMI I SHKURTER I DEPOZITIMEVE TRIASIKE

Ne ndertimin gjeologjik te rajonit, qe do te jete objekt i studimeve tona, hyjne depozitimet triasike te zones se Alpeve dhe te nenzones se Cukalit dhe pjeserisht te zones se Gashit.

Depozitimet e triasikut te poshtem

Zene pjesen qendrore te rajonit dhe kane pehapje te madhe (L.H.Peza etj. 1973, Z.Bicaj etj., 1981). Ne baze te tyre shtrihet nje pako konglome-




Fig.1 Kolona permbledhese e depozi-timeve triasike te zones se Alpeve (nenzona e Valbo-nes)

1. Shfaqje hekuri,
2. Shfaqje te boksideve
3. Anomali gjeokimike dytesore,
4. Oreola shli-hore te galenitit, sfa-leritit

General column of Triassic deposits of Albanian Alps zone (Valbona subzone)

1. Iron Deposit;
2. Bauxite deposit;
3. Geochemical Secondary Anomalies;
4. Galenit and Sphalerit




Fig.2. Prerje litologo-gjeokimike tek Grumbulli i Kuq, mbi Abat, Rajoni Dukagjin. (Lithological-Geochemical section at Grumbulli Kuq above Abat-Dukagjin Region)

ratike me zaje gelqerorësh, silicoresh e me çimentim ranor me trashesi rreth 40 m. Me siper vijojne rreshpe sericitike argjilore me pamje filitike me ndërshtrësë thjerrzore e blloqe konglomeratike me trashesi 80 m, qe pasohet nga pakua karbonatike rreshpore 130m dhe pakua e rreshpeve silico-argjilore me pamje filitike vende vende sericitike (300 m). Keto depozitime mbyllen me pakon rreshpore karbonatike. (130 m).

Ne Alpet Bergamaske (Itali) ne Triasin e positem (R.Assereto etj. 1977) kemi perfaqesimin me depozitime mergelore ranore kalimtare e detare (formacioni i Serrinos). Keto kushte vazhdojne ne te gjithë triasikun e perfundojne ne nje faze regresive (evaporitet e Karniola di Bovenjo). Ne Kordilieret Betike (Spanje) triasi i positem perfaqesohet nga filite e kuarcite. Ne Alpet (Zvicer) Triasi i positem perfaqesohet nga seria Melsler me aekozë bazale (me origjine kontinentale) dhe kuarcitet Melsler (S.Th Schmid etc, 1983). Ne paralpe (Zvicer-France), triasiku i positem perfaqesohet kryesisht nga nga kuarcitet. Ne Austri perfaqesohet nga kuarcite, rreshpe, ranore e me siper gelqerore. (A.Baud, 1987) Ne Dinaride (Slloveni) Triasiku i positem perfaqesohet nga dolomite. Ato permbajne

thjerza gipsi (M.Drovenik, 1983). Ne Malin e Zi keto depozitime si dhe ne rajonin e Vermoshit ne pjesen e poshtme jane formime klastike, ndersa me siper vijon normalisht facie karbonatike (L.H.Peza, D.Shkupi, 1988)

Depozitimet e Triasikut te mesem


Keto depozitime ndahen ne katet Anizian dhe ladinian (Fig. 2,3.). Depozitimet e Anizianit fillojne me nje pako konglomeratike (25 m) me zaje gelqerorësh e me pako ranoresh e shkëmbinjsh silicore. Me siper vijon pakua argjilore mergelore biomikritike.

Ne Dinaride dhe ne Alpe ka edhe facie Aniziane te perbera kryesisht nga gelqerore e dolomite. Me siper depozitimet aniziane vijojne me nje pako gelqerore silicore tufitike (60 m) Tufitet jane vitroklastike te perberjes andezite, ato jane alevropelitike a ne disa raste psamitike: Jane percaktuar amonitet. Arcantet ventricotis; Proarcestes sp., Emonophyllites sp.

Ne rajonin e Vermoshit depozitimet Aniziane i perkasin facieve neritike e perfaqesohen nga gelqerore e dolomite algore me pamje brezore e gelqerore te facies hanbulog. Ato perbejne dyshemene e horizontit hekuror.

Ne malin e Zi vijon e njejtja prerje si ne rajonin e Vermoshit. Ne Slloveni ato perfaqesohen nga gelqerore e dolomite, edhe ne Austri ato perfaqesohen nga gelqerore e dolomite. Vepriktaria vullkanike eshte treguar nga shfaqjet lokale te shtresave te tufiteve (M.Drovenik 1983). Ne Alpet Qendrore (Zvicer) Triasi i mesem perfaqesohet nga nje seri transgresive (Rotiserie) e qe perbehet nga dolomite e karbonate te depozituara ne facie lagunore (S.Th.Schmidt etc. 1983). Ne Para Alpe (Zvicer e France) depozitimet aniziane jane mjaft te perhapura, ato perfshijne formacionet e Shen Trifonit, qe formon bazen stratigrafike te Anizianit. Moshja e ketij formacioni perfshihet nga fundi i Triasit te poshtem deri ne Anizianin e siperm (A. Baud 1987).

Ne Alpet Bergamaske, ne anizian ne fillim jane depozituar dolomite te nderthurura me alevrolite ranore po me ne veri te Lombardise mbizoterojne faciet me detare te perfaqesuara nga gelqerore me te zinj me krinoide (gelqerore te Angolos). Ne Anizianin e siperm, ne veri depozitohen dhe mergele me amonite (gelqeroret e Prekos), gelqerore nyjore me straje te nderthurura me tufite (gelqerore te Buchensteinit) dhe ne fund mergele e kalkarenite turbititike (Formacioni i Vengenit) (R. Assereto et.al.1977). Ne Kordilieret Betike Aniziani perfaqesohet nga mergele, gelqerore, dolomite (J.M.Fontbote etj., 1983).



Cu — ; Pb — — — ; Zn — x — ;
Ba — o — ;

Fig.3. -Prerje Lito'logo-gjeo-kimike tek Shkrepi Mirrajes mbi Dragoj, Rajoni Dukagjin. (Lithological - Geochemical section at Shkrepi Mrrajes above Dragoj-Dukagjin Region).

Depozitimet ladiniane ndertojne ne Alpet Shqip-tare tabanin e horizontit boksitmbajtes. Ato perbehen nga pakua e dolomiteve (120 m), pakua e gelqeroreve - me gastropoda (150 m) me nje sasi te madhe algesh e gastropodesh. Keta gelqerore jane ndeshur edhe ne gelqeroret e Esino te Alpeve si edhe ne Malin e Zi.

Ne nenzonen e Cukalit depozitimet e Triasit te mesem jane te perfaqesuara me flishin me olistolite te Shporit, gelqeroret neritike masive te Barcolles, amonitiku i kuq i Pellumbit, qe vendoset mbi i jesi:ne e gelqeroreve te Barcolles dhe mbulohet nga vullkanitet. Formacionet e lartepmendura jane datuar si te Anizianit te siperm-Ladinianit. ndersa vullkanitet trajtohen si te moshes

Ladiniane.

Gelqeroret e kuq brekcior (64 m) te Shporit vendosen ne njesine e flishit turbitik me olistolite te Shporit dhe mbulohen nga njesia e radiolariteve te kuq me tufite (P. Theodori etj., 1987).

Shkembinjte vullkanike te nenzones se Cukalit perfaqesohen nga lloje bazike deri acide me prirje alkaline. Jane analoge me formacionin Porfirite-Hornshtejn. Brenda shkembinjte vullkanike takohen thjerza, shtresa te holla e blloqe te vegjel shkembinjsh sedimentare gelqerore nyjore te facies "Han Bulog", rreshpe mergelore radiolaritike e me rralle radiolaritike te kuq.

Ne rajonin e Vermoshit mbi formacionin vullkanogjeno-sedimentare shtrihen gelqerore e gelqerore te dolomitizuar ose dolomite. Ne keto depozitime eshte takuar *Baccanella floriformis* Pantic etj.

Ne Malin e Zi vijojne formacione me faune ladiniane te mirefillte. Ne Silloveni, depozitimet ladiniane perfaqesohen nga gelqerore e dolomite (H.Drovenik 1983). Ne Austri keto depozitime perfaqesohen nga gelqerore e dolomite. Nganjehere midis ketyre depozitimeve ndeshen nderthurje mergelesh e gelqeroresh ranorike. Veprimtaria vullkanike eshte shprehur me shfaqjen vende-vende te shtresave te tufiteve ne gelqeroret Wettershtajn te Ladinianit (W.R.Janoschek etj., 1980) Ne Alpet qendrore (Zvicer, France) depozitimet ladiniane perfaqesohen nga dolomite e gelqerore dhe nuk ndahen lehte nga ato aniziane (S.Th.Schmid etj. 1983).

Ne Para Alpe (Zvicer, France) keto depozitime perfaqesohen nga dolomite, gelqerore, dhe shtresa gelqerore e dolomitesh me *G.Goldfussi* (A.Baud, 1987). Ne Alpet Bergamaske e njesine stratigrafike te Ladinianit hyjne gelqeroret e Esinos (gelqerore e dolomite me gastropode e brahupode). Mbi gelqeroret e Esinos vendosen me mospajtim gelqeroret e kuq (mikrite me ostrakode e foraminifere e gastropode te medhenj). Mbi keta gelqerore vendoset formacioni Brenos qe perbehet nga tre horizonte: i poshtem me nderthurje mikritesh e gelqeroresh stromatolitik, i mesem qe ka ne baze nje nivel argjilo-turitike e vijon me gelqerore mikritike dhe si i trete perfaqesohet nga mikrite nga mikrite e pelimikrite me fosile te shumta (midis te cilave *Clypenia besici* etj.) Brenda gelqeroreve te Breno-s ndeshen nderthurje te imta tufitike. (R.Asserto etj., 1977)

Ne kordilieret betike depozitimet ladiniane perfaqesohen nga gelqerore, dolomite mergele dhe nderthurje vullkanitesh bazike (J.M. Fontbote etj., 1983)




Fig.4.

1. Gelqeror Ezino; 2. Gelqerori i Kuq; 3. Formacioni Brenos. 4. Gelqerore metalifer Bergamaske 5. Gjuha e Poshtme e formacionit te Gornos 6. Formacioni i Gornos 7. Ranori i Val Sabias.

1. Esino limestone 2. Red limestone 3. Breno Formation 4. Metalifer Bergamaske limestone 5. Lower member of Gorno Formation 6. Gorno Formation 7. Sabia sandstone. (After R.Asserto etc.1977)

Depozitimet e Ladinian-Karnianit

Kane perhapje te kufizuar ne zonene e Alpeve shqiptare dhe jane quajtur suita e Thethit. Ato ndeshen ne dy shpatet e lugines se Thethit e ne perroin e Gjon Marashit, perfaqesohen nga pakua me shtresa gelqeroresh mikruditike 120 m ndermjet bivalvoreve te pjeses se siperm te kesaj pakuje jane takuar *Posidonia wengensis* WISH Ladinian dhe pakua e gelqeroreve biomikritike 315 m, qe perfaqesohet nga gelqerore-biomikritike, mergelore bituminoze me ngjyre potuajse te zeza (moshe Ladinian-Karniane).

Depozitime te triasikut te triasikut te siperm

Keto depozitime perfshijne te tre katet e triasiku te siperm dhe kane perhapje te madhe ne Alpet Shqiptare (L.H.Peza, 1973, Z.Bicaj, etj., 1981) Gjeologjia e Shqiperise, 1982) Ato perfshihen nga keto pako:

a. Pakua dolomitike (230 m) Ne pjesen me te poshtme ndeshet nje shtrese brekcesh gelqerore me trashesi 60 cm, qe gjate shtrirjes zevendesohet nga trupi i boksidit. Perhapje ne keto pako kane stromatolit.

b. Pakua e gelqeroreve biomikritike me shtresa te holla te stromatoliteve algore (250 m)

c. Pakua me gelqerore stromatolitike (315 m)

d. Pakua gelqerore biomikritike (215 m)




Fig.5 Seri stratigrafike te koreluara ne Val Brembano (sipas R.Assetto etj. 1977)

1. Gelqerore e gelqerore dolomitike 2. Gelqerore me ngjyre hiri te erret ne te zeze 3. Tepel epizolite 4. Nivele me blloqe stromatolite 5. Horizonte argjilo-tufore 6. Gastropode e Lamellibranke

Stratigraphical series at Val Brembano (After R.Asserto etc. 1877)

1.Limestone and dolomitic limestones 2. Gray limestones 3. Episolites 4. Level with stromatolites 5. Clays-tuffits-level 6. Gastropodes and Lamillibranches.

Ne nenzonen e Cukalit depozitimet e Triasikut te siperm perfaqesohen nga gelqerore te Fesekut (80 m) Ato permbajne silicore te shumte, te vendosur

paralel me shtreshezimin. Gelqeroret e Fesekut vendosen mbi gelqeroret e kuq konglobrecore te Shporit te Anizianit te siperm -Ladinianit. (P.Theodhori etj. 1978). Analoge moshore te tyre jane gelqeroret e Prekalit (135 m) qe perfaqesohen nga gelqerore radiolaritike mergelore te nderthurur me silicore. Afer Prekalit ne kete njesi eshte ndeshur nje nivel me Daonella.

Gjate Karnianit te poshtem ne pellgun Lombardian platformat karbonatike hyjne ne krize per shkak te dy faktoreve : nga nje ndryshim i mundshem klimatik drejt kushteve me lageshti me te madhe (dukja e mbetjeve bimore etj,) dhe nje faze e pergjithshme tektonike e shoqeruar me nje veprimtari vullkanike. Ne catine e formacionit te Brenos vendoset i




Fig.6 Profile skematike qe tregojne pozicionin paleogeografik te depozitimeve triasike e te Kordilieres Betike te krahasuara me ato te Europes Qendrore. (Sketch profiles, that show Paleogeographical position of Triassic deposits of Betic cordillera compared with those of Central Europe. After I. Fontboté etc., 1983).




Fig.7. Krahasimet litostratigrafike te sekuencave Permo-Triasiqe ne kordileret Betike (Spanje)

a- Filite; b- Kuarcite; b- Mergele; d- Gelqerore; e- Dolomite; f- Dolomite te erreta; v- Vullkanite; g- Shtresore; h- Damarore.

Comparisons of lithostratigraphical Permo-Triassic sequences at Betic Cordillera (Spain) (After J. Fotbote etc. 1983). a- Phylites; b- Quarzits; c- Marls; d- Limestones; e- Dolomites; f- Dark dolomites; v- Volcanites; g- Layers; h- Veins.

ashtuqajturi gelqeror metalifer Bergamaske me 14-18 m trashesi qe perbehet nga gelqerore pelitike bazal, gelqerore stromatolitike e gelqerore te straje.

Mbi gelqeroret metalifere bergamaske shtrohet ranori i Vaissabies dhe formacioni i Gornos qe perbejne Karnianin e mesem e te sipem. Formacioni i Gornos (rreshpe te zeza pak gelqerore e argjilo-mergelore) del ne dy trupa shkembore te ndare nga nderthurja e Ranorit te Val Sabbias. Keta dy trupa quhen "Gjuha e poshtme": dhe "pjestari i siperm" (gelqerore mikritike e mergele 140-180 m).




Fig. 8. Seria stratigrafike e detajuar e formacionit te Brenos afer Paglio Pognolinos.

Detailed stratigraphical serie of Breno formation near Paglio Pignolino (After, R, Assereto etc., 1977).

Vijimesia karniane mbyllet me sedimente regresive te facies evaporitike 120-150 m, (R.Assareto, 1977) (Fig.4.5). Ne Slloveni depozitimet e Triasikut te siperm perfaqesohen nga gelqerore e rreshpe (M.Drovenik, 1983). Ne Austri ne Karnian ndeshen shtresat Raibl (rreshpe ranore dhe evaporitike). Ne pjeset lindore jane te zhvilluara shtresat Lunz qe jane nderthurje te rreshpeve, mergeleve ranore dhe arkozeve me shtresa qymyri e gelqerore te tipeve te ndryshme (F.R.Janoschek etj. 1980) Ne Alpet Qendrore (Zvicer) Triasiku i siperm perfaqesohet nga sedimente pelagjike e detritike kryesisht gelqerore e kuarcite (S.Th Schmid etj., 1983). Neper Paraalpe (Zvicer, France) Karniani eshte i pefaqesuar nga dolomite e gelqetore dhe me siper nga formacione brekcioze (brekcie dolomitike. Ne Kordilieret Betike (Sierra de Lunja) depozitimet e Triasikut te siperm (Karnian-norien) perfaqesohen nga dolomite, gelqerore rreshpe vullkanike bazike (J.F.Fontbote, etj. 1983)

PERHAPJA E MINERALIZIMIT SEDIMENTAR NE DEPOZITIMET TRIASIKE

Nje vemendje e vecante i eshte kushtezuar problemit te mineralizimit te lidhur ne shkembijnje triasike. Pjesa me e madhe e studimeve i lidhin keto mineralizime me proceset e daljes mbi uje (emersionit) dhe perqendrimet e elementeve te lidhura me te. Pasurimi xeherore kryesisht Pb-Zn nepermjet karstezimit (Bleiberg, Raibl, Mezgica etj.) Po emersioni dhe karstezimi mund te kete rendesi per permasat dhe format e trupave xeherore po nuk jane shkaqe vendimtare per pasurimin me Pb, Zn, Fe, Ba e Si. Pasurimi me keto elemente mund te shpjegohet nga shplarjet ne zonat e sedimentimit. Ngjasimet e medha midis vendburimeve shtresore te xeherorizimit ne Alpuaride (Kordilieret Betike) dhe ne Alpet lindore e Dinaridet, rezultojne nga kushtet e ngjashme gjeologjike gjate formimit te tyre.

Gjate Triasikut Alpet Qendrore kane qene nje sektor kalimi paleogeografik te diferencuar mire nga platforma Evropiane pas Varisike ose Alpine e jashtme ne veri ku ishin depozituar litofaciet Alpine e Triasike. Ne keto mjedise u formuan shume vendburime Pb-Zn qe kane ne perberje te tyre fluorite. Si shembull jane vendburimet e Blaibergut, Raible, Solaffosa, Topla, Mezgica etj. ne faciet Alpine dhe vendburimet e Silezise se sipem, Meubah-Mehirmih etj. ne litofaciet gjermane (Fig.6).

Triasi eshte nje periudhe e privilegjuar per sa i perket mineralizimit te fluoritit. Ne Evropen Qendrore e perendimore te pakten jane dalluar tre treva




Fig.9. Lokalizimi stratigrafik i Celestines dhe fluoritit ne Triasin e mesem te Para Alpeve mesore (Sipas A. Baud, 1987)

Fl-Fluoriti; Ce-Celestina.

Stratigraphical location of Celestine and fluorines in Middle Triassic Prealpes-Swiss (After A. Baud, 1987).

paleogeografike te rendesishme qe jane te favorshme per pranine diagjenetike te fluoritit.

1. Trevat e gjera te transgresionit mbi ose me anen e masiveve hercinike ne nje mineralizim te ranoreve te bazes ose te dolomiteve
2. Trevat e platformave te medha karbonatike pak te thella ose me pak te kufizuara, me nje mineralizim ritmik ose mineralizimin selektiv ne gelqeroret e dolomitet.
3. Mbushjet karstike intra-triasike te disa platformave karbonatike

Vendburimet e Alpuarideve (Kordilieret Betike-Spanje)

Ne shkembijnje triasike te komplekseve Nevado-Filabride e te Alpuarideve (I.E.Fontbote etj. 1983) njihen tre grupe vendburimesh shtresor:

- a. Vendburim Fe ne kompleksin Nevado-Filabride (dhe napat me te poshtme te Alpuarideve) miniera Alkuife eshte me e rendesishme ne kete grup.




Fig. 10. Lokalizimi i xeheroreve ne Passo della Greina (Sipas S.Schmidt etj. 1983).

a- Bazamenti paleozoik; b- Horizont i tjetersuar; c- Karbonate; d- Mermere dolomitike; e- Kuarcite; f- Rreshpe.

Location of ores in Passo della Greina (After. S.Schmidt etc. 1983).

a- Paleozoic basis; b- Altered level; c- Carbonates; d- Dolomitic marbles; e- Quarzites; f- Schists.

b. Vendburime F(Pb-Zn) ne napat e Alphuarideve te poshtme. Ne kete grup perfshihen vendburimet e Sierra de Luharx, Sierra de Gadar dhe Sierra de Baza.

c. Vendburimet e Kartagjenes, kryesisht Pb-Zn-Fe-Ag; vendburimet me te rendesishme te F-Pb-Zn gjenden ne Sierra de Luhar, Sierra de Gadar dhe Sierra de Baza, ku nga mineralizimet me i bollshem eshte fluoriti. Galeniti dhe sfaleritit jane te pranishem

pothuajse kudo. Piriti dhe kalkopirit jane ne sasi te vogla. Mosha e tyre mendohet si Ladinian i siperm-Karnian. (Fig.7).

Vendburimet e Alpeve Bergmaske (Itali)

Mineralizimi kryesor ne rajonin e Alpeve Bergmaske eshte i perqendruar ne afersi te kalimit midis depozitimit te platformes karbonatike

dhe te facieve kalimtare e Lagunore te Karnianit Mineralizimit e Presolanas ndodhen midis shkembinjve te Karnianit te mesem (formacioni i Drenos) ai Gornos midis sedimenteve te Karnianit te poshtem, ai i Palio Pinjolinis e M. Vakarexhias ne formacionet e ladinianit te siperm e te karnianit te poshtem (formacioni i Ezinos dhe i Brenos) (R. Asereto etj. 1977).

Ne vendburimin e Palio Pinjolinis dallohen tre tipe mineralizimesh:

a- Mineralizimi i I (i poshtem) i vendosur 50-60 m ne kufirin e siperm te formacionit te Brenos(Fig.8).

b- Mineralizimi II (i mesem) i lokalizuar ne pjesen e siperm te formacionit te Brenos nga 2-30 m ne kufirin e çatise.

c- Mineralizimi III (i siperm) me kalimin midis gelqerorit metalifere Bergamask dhe gjuhen e poshteme te formacionit te Gornos.

Mineralizimi I Ndodhet ne xhepa me permasa te ndryshme te vendosura 50-60 m ne çatine e formacionit te Brenos. Forma e xhepave eshte e pavarur nga shtresizimi dhe kryesisht ne formen elipsoidale ne kufinj te çrregullt. Permasat luhaten nga disa dm ne 20 m. Mineralizimi eshte i perbere nga sfaleriti e galeniti e nga sasi te vogla fluoriti pa ngjyre ne kokrriza te medha. Ky mineralizim perfaqeson mbushjen kimike te boshlleqeve karstike me te thella te formuara se fundi. Kjo gje vjen nga levizshmerija e fluideve gjate diagjenezes se sedimenteve te brendeshme.

Mineralizimi II eshte i rendesishem nga pikpamja industriale dhe perfaqeson 90 % te fluoritit te nxjershem. Pervec fluoritit ne kete horizont ndodhet vende-vende ne bollek galeniti, piriti e markaziti. Ky mineralizim ndodh te nje sistem boshlleqesh (kavitetesh) thjerezore. Trupat kane gjatesi rreth 100 m, gjeresi 5-10 m e trashesi 9 - 12 m. Mineralizimi i dyte zhvillohet si mbushja e brendeshme e blloqeve karstike, te krijuar ne pjesen e siperm te formacionit te Brenos.

Mineralizimi III- Stratigrafikisht eshte i lokalizuar ne majen e gelqerorit Metalifere Bergamask dhe horizontin e poshtem te gjuhes bazalte te formacionit te Gornos. Perqendrimet me tipike jane te vendosura ne rreshpet e mergelet me straje te horizontit te Gornos bazale, te perfaqesuara nga fluorite bituminoze ngjyre vjollce. Ne Karolina Piezzona mineralizimi duket i perqendruar ne rreshpet kuarcore bituminoze. Horizonti i mineralizuar eshte mbuluar nga mergele me fleteza e nyje strajesh sterile.

Karakteristika e tij eshte te qenet e nje mineralizimi sindiagjenetik me fluorit e silic. Gjate diagjenezes formohet fluoriti bituminozi i ri - vjollce me kristalet e gjata ne petezim. Substancat organike jane te shoqeruara me sulfure te piritit e gjurme sfaleriti.




Fig. 11. Stratigrafia e triasikut ne zonen e Breibergut, Austri (Sipas H. Holzer, 1980.)

Stratigraphy of Triassic in Breiberg zone (After H. Holzer, 1980).

Ne vendburimin e fluoritit te Palio-Pinjolinjos procesi metalformues duket i lidhur.

a- Gjenetikisht: ne fazen e sedimentimit horizonti i siperm i gelqerorit metalifere Bergamask - Horizonti i poshtem i gjuhes bazal te formacionit te Gornos qe i korespondon kalimit midis facieve te retroplateformes (horizontet e poshtme e te mesme te metaliferit Bergamask) dhe facieve kalimtare e lagunore te Karnianit.

b- Ne hapsire: ne strukturat kurthe te krijuara ne vijim te fazes se ngritjes mbi uje (emersionit) dhe erozionit ne majen e gelqerorit metalifere Bergamask dhe te dukurive karstike.

Vendburimet e formacionit te Shen Trifonit (Zvicer, France)

Ne platformen e Triasikut te mesem briansonoz qe hyjne ne treven e dyte te madhe (A. Baud 1987), jane zbuluar perqendrime fluoriti ne dy nivele. I pari nenjesine 4f, ne luspen e Brithornit (baze e Anizianit te siperm) dhe i dyti ne ciklin e trete (shtresat me Costatorja galdfussi) (Fig. 9) te luspes Vierlehornit. Mineralizimi i fluoritit eshte i formuar ne mjedise sedimentare e diagjenetike te krahasushme me mineralizimin e ndeshur ne gelqeroret e Watershtanjit te rajonit Brejbergut-Kreuth (Austri) (Schneider et al. 1975.) si dhe gelqeroret e triasikut te siperm ne Sierra de Luhara (Spanje). Po ne keto rajone perqendrimet e fluoritit jane te shoqeruara me mineralizime bariti dhe sulfure te Pb e Zn, ndersa ne Para Alpet (ne formacionet e Shen Trifonit ai shoqerohet nga celestina).

Vendburimet e Alpeve Qendrore (Zvicer)

Si shembull nga keto vendburime po japim vendburimet e Passodello Greina. Depozitimet triasike ne Passo della Greina kapin nje trashesi rreth 200 m. Ne kete sektor jane ndeshur shtate shfaqje mineralizimesh te dobishme. Sekuenca triasike e Passo della Greines eshte stadi fillestar i nje sekuence transgresive, ne te cilen jane depozituar sedimente detrike, karbonatike pelagjike (S.Th.Schmidt etj. 1983).

Shfaqja e pare e lokalizimit ne Passo della Greina (Fig.10.). Mineralizime sulfure, bariti dhe fluoriti ndodhen ne horizontet Nr. 47, 60, 68 dhe 69 dhe ne sasi te vogla ne horizontet Nr. 50, 56, 63. Horizonti i 60 perbehet nga kuarcite me trashesi 40 m ndersa ai eshte ne pako kuarcitetesh qe permban fluorit-sericit-barit.




Fig.12 Kolona e pergjithesuar e shtratimeve sedimentare te Triasikut te poshtem, te mesem e pjeserisht te siperm me pozicionin stratigrafik te v.b. te Pb-Zn dhe Zn-Pb. (Sipas M. Drovenik, 1983)

1-Dolomite; 2- Gelqerore; 3-Rreshpe; 4-Trupa xeheror pajtues; 5- Trupa xeheror mospajtues.
Generalized Column of sedimentary beds of Lower Middle and partly Upper Triassic, with stratigraphical position of Pb-Zn and Zn-Pb deposits (After M. Drovenik, 1983).
1- Dolomites; 2- Limestones; 3- Schists; 4- Concordant ore body; 5- Discordant ore body.

Duke e krahasuar keto vendburim me vendburimet e tjera del se keto shfaqje nuk jane perjashtime. Perberja e tyre minerale ne shkembinjte meme dhe gjeometria e trupave te tjere jane te ngjashem me shfaqjet e tjera te Triasikut te Zvicres, Alpeve Lindore e Jugore dhe te Europes Qendrore. Per shkak te ketyre shfaqjeve keto gjenden ne bazen e sekuences transgresive mesozoike.

Vendburimet e Alpeve Lindore (Austri)

Ne shume njesi tektonike te Alpeve Lindore jane gjetur xeherore te Pb-Zn (H. Hotzer etj. 1980. Rajonet me te rendesishme jane ai Drauzug-ut dhe ai i maleve Karavanka. Sot veprimtaria e mineraleve eshte perqendruar ne tre miniera: ne Predil-Raibl (Itali), Bleiberg- Kreuth (Austri) dshe Mezhaica-

Mies (Jugosllavi). Ne Bleiberg-Kreuth ne Karanti, kryesisht, gelqeroret dhe dolomitet e Triasikut te siperm (Wetterstein) po dhe shkembinjte karbonatike te ledinianit dhe anizianit permbajne sfalerit dhe galenit.

Vendburimi i Bleibergut eshte tashme e vetmja miniere ne Austri qe prodhon plumb-zink (Fig.11.) Trashesia e pergjitheshme e depozitimeve triasike ne vendburimet e Bleibergut arrijne ne 300 m. Mineralizimi ne keto vendburim eshte i gjetur ne kater nivele stratigrafike brenda sekuences se Wetterstein-it me trashesi 290 m. Prania e stromatoliteve, ritmiteve, brekchieve te zeza te risedimentuara, kalkareniteve dhe mergeleve te gjelberta tregon per depozitim ne nje lagune te ceket. Sekuencat ciklike jane karakteristike dhe perbehen nga sedimente litorale duke perfshire shtresa evaporitesh me barit, anhidrid dhe fluorit (fig.11).

Kater nivelet e mineralizuara jane:

1- Poshte "Bankos-Megalodus" rreth 200 m poshte horizontit ne Cardita. Ne keto nivel ndeshen trupa xeherore shtresore me permasa te kufizuara (100 m diamater e 1 m trashesi).

2- Ne pjesen me te sipërme te gelqerorit Westersteinit midis pakos Megalodus dhe horizontit te pare me Cardita.

3- Dolomiti i mesem i horizontit te pare Cardita qe perfshin trupat xeherore me shume se 5 m te trasha dhe disa qindra metra diamater.

4- Sedimentet gelqerore dhe dolomite ne tabanin rreshpit te trete me Cardita.

Mineralizimi ndodhet ne thjerza me tipare te dallueshme sedimentare. Mineralet kryesore jane: galeniti, sfaleriti, me permbajtje te vogla te piritit, markazitit, baritit dhe sideritit. Mineralet damaror jane: kalciti, fluoriti dhe bariti.

Vendburimet e Sllovenise

Me shkembinjte karbonatike triasike jane te lidhur disa horizonte vendburimesh. Vendburimet ne shkembinjte karbonatike te Skithinianit e te anizianit permbajne trupa minerale shtresore pajtues, po ne Ladinian shtratimet e trupave xeheror presin shkembinjte karbonatike qe jane te lidhura me hedhjet. (M. Drovenik, 1983). Mineralet kryesore te dobishme jane galeniti e sfaleriti te shoqeruara nga piriti dhe markaziti (ne sasi te pakta). Ne Skithinin e poshtem dolomitet permbajne thjerza gipsi dhe trupa

minerale pak a shume pajtues me formacionet rrethuese. Vendburimi i ketij horizonti eshte ai i Bohorit.

Vendburimi i Zn-Pb, te Topleles ndodhet ne depozitimet karbonatike te Anizianit dhe gjenden ne Karavanket Veriore rreth 8 km ne perendim te Mezhices. Topila perfaqeson vendburimin me preardhje sindiagjenetike me te sigurte. Trupat thjerrzore jane pothuajse me dolomitet. Ne saje te mjedisit rrethues formohet mineralizimi i sulfureve te Zn dhe Pb gjate diagjenezes te shoqeruar nga piriti e markaziti.

Pergendrimet me te rendesishme te Pb e Zn te Sllovenise jane ne Ladinian dhe pjeserisht ndoshta dhe ne shkembinjte karbonatike te Karnianit te Mezhices (Fig.12). Aty njihen shume tipe trupash, po ne pjesen qendrore te vendburimit jane me te rendesishme trupat pajtues e mospajtues. Trupat pajtues jane pak a shume paralele me shtresizimin e gelqeroreve dhe dolomiteve xeherore pajtues. Trupat mospajtues jane te vendosur gjate zonave te hedhjeve. Te parat jane formime sedimentare te dytat formime epigjenetike. Perberesit kryesore jane: galeniti, sfaleriti, piriti, markaziti. Ne sasi shume te vogla takohen edhe virciti, arsenopiriti dhe molibdeniti.

Shfaqjet Minerale ne depozitimet triasike te Shqiperise se Veriut (Rajoni i Shkodres)

Deri tani ne depozitimet triasike te rajonit te Shkodres jane zbuluar mineralizimi boksitesh dhe hekuri. Mineralizimet e hekurit jane ndeshur ne Domen, Golish (Tarabosh). Ne Domen, ndodhet ne depozitimet anizian-ladiniane ne trajte thjerrzash te pasura me hekur (Fe-60 %), ndersa ne Golish horizonti hekuror vendoset ne pjesen e sipërme te depozitimeve aniziane, dhe ndertohet nga thjerrza hematitike te ralla me trashesi 0.6 m, te shoqeruara me oreola polometalore, qe te bejne te mendosh per te thelluar studimet gjeologjike lidhur me mundesine e gjetjes se trupave te mineralizuara paresore (polimetalore) ne kete rajon .

Horizonti i boksiteve ka nje shtrirje 2,5 km nga Qafa e Grades deri ne Qafen e Kakise, me trashesi 0,1-1.2 m. Perfaqesohet nga zona e perpunuar mbi nje dysheme karstike, ndersa ne pjesen lindore karsti eshte me pak i zhvilluar. Duhet theksuar se brenda horizontit takohen disa shtresa argjilash, boksitike. Siper tyre jane te vendosur depozitimet triasike te siperm. Ne pjesen lindore brenda horizontit ndeshen edhe gelqerore e mergele me trashesi 5-15 m. Horizonti ka trashesi nga 1-7 m. Horizonti boksitik perfaqeson pushimin stratigrafik midis Ladinianit dhe Karnianit.

Duke vrojtuar me kujdes hartat e oreolave dhe anomalive te shperndarjes se elementeve Pb-Zn del se keto oreola apo anomali ndeshen poshte shpateve qe ndertohen nga depozitimet karbonatike te Triasikut te mesem e kryesisht te atyre aniziane eme pak te depozitimeve ladiniane e karniane. Ne kete rast vlen te permenden oreolat e Xhanit dhe te Planit per galenit dhe sfalerit si dhe oreolat e Nenmavriqit dhe te Pecaj Abatit per elementet Pb-Zn qe jane perfituar poshte shpateve te Majes se Boshit te majes se Eshellit dhe te majes se Fratit. Depozitimet qe perfshijne keto shenja jane karbonatike dhe i perkasin triasikut te mesem (kateve anizian e ladinian). Duke perdorur metodat gjeokimike te llumrave jane fiksuar anomali te Pb-Zn (te galenitit, sfaleritit). Mineralizimet polimetalore jane takuar ne forme blloqesh, dhe copash ne sektorin e Lekgjonajt dhe te Vuksanajt ku jane kryer punimet te kerkimit te lehta siperfaqesore deri ne shpime, duke mare vetem rezultate negative per shkak te mosnjohjes se preardhjes se ketyre mineralizimeve e te mos saktesimit te perkatesise se depozitimeve me te cilat lidhen. Deri tani nje gje eshte sqaruar, qe blloku me permbajtje polimetalesh ne Lekgjonajt lidhet me shkembinjte karbonatike te perbere nga gelqerore mjaft te rikristalizuarm ku mineralizimi perfaqesohet nga barit-sfalerit-galenit e kalkopirit te shprehura jo uniformisht ne masen shkembore.

Te gjitha keto oreola e anomali si dhe copat e blloqet e mineralizimit polimetalore flasin per nje jehone te ketij mineralizimi ne prerjen mesozoike karbonatike apo detritiko-karbonatike te zones se Alpeve Shqiptare. Nga keto te dhena del se ende nuk eshte thene dika per keto mineralizime ne depozitimet triasike.

Po te lidhemi me depozitimet analoge te treves Alpine duke filluar nga Kordilieret Betike (Spanje), ne France, Zvicer, Austri, Itali dhe Jugosllavi veme re se duke pasur kushte te ngjashme gjate formimit te tyre, nuk eshte rastesi qe ne te gjitha vendet e vendburimet e lart permendura jane gjetur ne keto depozitime vendburimete te rendesishme sedimentare te Pb-Zn, te fluoritit, baritit etj. Perhapja fluoritit ne depozitimet triasike reflekton ndryshime faciale e paleogjeografike te depozitimeve te ndryshme. Pergjithesisht pasurimi me fluorit eshte i kufizuar ne pak shtresa vetem brenda sekuencave sedimentare.

a- Dolomitizimi i hershem diagjenetik dhe bashkefunderimi i fluoritit ne sektore te veante te mjedisve intertidal (mediolitorale) dhe supratidale (supralitorale).

b- Fiksimi adsorbiv i F ne mineralet argjilore ne shkëmbinjte karbonatike duke nenvizuar ndryshime paleogjeografike.

I. Gjeneracioni i pare perfaqesohet nga fluorite qe tregon se jane prodhime sedimentare. Jane tipike ritmet e shtresave te nderthurura te sfaleririt ose te dolomitit e te fluoritit.

II. Fluoritet e gjeneracionit te dyte tregojne per nje rimobilizim te mevonshem diagjenetik.

III. Gjeneracioni i trete eshte i perfaqesuar nga fluoritet te rimobilizuar me kristale te vegjel ne te carat e hapura ose fluorite qe cimentojne pjesen e brekçezuar te shkëmbinjve (ne brekçiet mospajtuese).

Fluoritet e Palio Pinjolinis jane dy tipesh:

I. **Tipi i pare** - mineralizim shtresore brenda metaliferit Bergamas i funderuar ne nje lagune te brendeshme.

II. **Tipi i dyte** - mineralizim epigjenik brenda boshlleqeve ne pjesen e sipërme te formacionit te Brenos te ngritura tej lagunave te brendeshme.

Ne teresi ne depozitimet triasike fluoriti eshte mineralizim baze ne te gjitha vendburimet e njohura. Ai bashkeshoqerohet me minerale polimetalifere (Pb-Zn) por ne depozitimet e Shen Trifonit (France-Zvicer) vendin e polimetalifereve e ze celestina (mineral i strociumit).

Nga studimi teresor qe i beme materialeve gjeologjike qe kane te bejne me mineralizimet ne depozitimet triasike te Treves Alpine, duke i krahasuar ne depozitimet triasike te Shqiperise se Veriut, kemi mendimin se mineralizimet e sipershkruara duhet te kerkohen edhe ne trevat tona, por natyrisht jo me metodat e perdorura me pare. Nje gje tjetër duhet patur parasysh ne kushtet e vendit tone. Po te krahasojme teresisht prerjen karbonatike te Alpeve Shqiptare veme re se te e njejta prerje ndeshet ne te gjithë prerjet mesozoike te treves Alpine. Mirpo ne to ndeshen vendburimet Pb-Zn e fluoritit ne horizontet e ndryshme duke filluar nga Permiani qe kretak. Duke u mbeshetur dhe ne mendimin e gjeologeve amerikane qe trajtojne formimin e mineralizimeve te Pb-Zn ne te njejten rruge si formimin e hidrokarbureve te naftes dhe te gazit, per vete natyren migruese te ketyre elementeve atehere trupat e mineralizuar duhet ti kerkojne edhe ne pjeset me te sipërme te prerjes karbonatike te zones se Alpeve.

LITERATURA

Assereto F., Jadoul F., Omenetto F. 1977 - Stratigr. e metallogenesi del settore occidentale del distretto e Pb-Zn fluorite barite di Gorno (Alpi Bergamasche).

Bakalli F. etj., 1973 - Informacion mbi simpoziumin nderkombetar mbi vendburimet e Alpeve, Bled (Jugosllavi).

Baus A. 1987 - Stratigraphie e sedimentologie des calcaires de Saint Triphon (Trias, Prealpes, Suisse et France). Memoire Lausanne. Nr.1.

Bicaj Z., Qirinxhi A., Peza L. Etj. 1981 - Ndertimi gjeologjik dhe mineralet e dobishme te rajonit Runice-Theth-Boge. Tirane.

Bushati Sh., Gucia B. etj. 1987 - Projekt mbi kerkim-rilevimin gjeologjik te shkalles 1:25.000 ne rajonin e Thethit Vuksanaj si dhe te marshutave ne rajonin e Maja e Bishkashit dhe Maja e Ndreut.

Deda S., Shallo M. etj. 1972 - Ndertimi gjeologjik dhe mineralet e dobishme te Shqiperise se Veriut., Tirane

Drovenik M. 1983 - Mineral Deposits in Permian and Triassic beds of Slovenia (ne Mineral Deposit of the Alpe Berlin-Tokyo-New York).

Finlew Bates T., Tinchler S.E. 1983 - Controls in Alpidic Mineralization Styles.

Fonbote J.M., Fontbote L. And Amstutz G.C. 1983 - Observations on the setting of the strata-bound F-(Pb-Zn) depozits in the triassic of the Alpujarides (Betics Cordiliere, Southern Spain).

Grillo V., Turku I., Bakri S., Nikolla M. 1983 - Studim tematiko-pergjithesues e rilevuar per kerkimin e polimetalëve ne rajonin e Dukagjinit (Vermosh), Tirane.

Gjata Th. Etj. 1985 - Studim mbi stratigrafine e depozitimeve triasiko-jurasike te Albanideve Lindore dhe premisat per mineralmbajtjen e tyre. Tirane.

Hien U.F. and Schneider H.J. 1983 - Fluorina anomalies accompanying Geochemistry of their fluorites.

Holzer H.H., Stumpf E.F. 1980 - Mineral deposits of the Eastern Austria (Outline of geology of Austria).

ISPGJ 1982 - Gjeologjia e Shqiperise. Tirane.

Jadoul F., De Boni A. 1981 - Paleogeografia e aspetto strutturale delle mineralizzazione a fluorite nella dolomia principale delle prealpi Bergamasche. L'industria minerare, seria III, An-2, Nr.1.

Janoschek W.R., Matura A. 1980 - Outline of Geology of Austria. Wien.

Peza L.H. etj. 1969 - Dep. triasike ne Lug. e Valbones. Perm. Stud. Nr. 14.

Peza L.H., Shkupi D., Turku I., Terolli I. 1988 - Stratigrafia, paleogeografia dhe konkretizimi i perspektives per hekur ne rajonin e Vermoshit. Tirane.

Peza L.H. 1973 - Stratigrafia e depozitimeve mesozoike te zones se Alpeve Shqiptare. Tirane.

Qirinxhi A., Bicaj Z. etj. 1984 - Ndertimi gjeologjik dhe mineralet e dobishme te rajonit Kir-Ndreaj-Brazhde. Tirane.

Schmidt S.Th. and Amstutz G.B. 1983 - Mineralogical Investigations of strata-bound Pb-Zn-Ba occurrences in the Triassic of the Central Alps (Switzerland).

Schneider H.F. et al. 1977 - Fluorite contents of carbonates sequences and rare earths distributions in fluorites of Pb-Zn Deposits in East-Alpines Mid-Triassic. Mineralium Deposits, 12.

Schroll E. 1983 - Geochemical characterization of the Bleiberg Type and other carbonate hosted Lead-Zinc Mineralizations.

Schultz O. 1983 - Recent results and critical considerations of the eastern alpine metallogenesis.

Toska Z., Halili R. Etj. 1983 - Studime komplekse gjeologo-rilevuese e kerkuese per sqarimin e perspektives se boksiveve ne zonen e Alpeve te Shkodres (Kelmend-Dukagjin). Tirane.

Theodhori P., Bushati Sh., Pirdeni A. 1978 - Stratigrafia e punimeve mesozoike te zones se Cukalit dhe disa probleme te mineralmbajtjes. Tirane.

Xhomo A., Peza L.H., Pirdeni A. 1975 - Nje kontribut per njohjen e stratigrafise se zones se Kraste-Cukali (nenzona e Cukalit). Permb. Stud., Nr.2, Tirane.

**Redaktor: Bshk. Shk. Abedin XHOMO
Prof. Dr. Radium AVXHIA**

SUMMARY

Sedimentary mineralizations of F-Pb-Zn in Triassic deposits of Alpine Belt and the possibility to find them in Northern Albania.

In this paper the authors give a comparison of Triassic deposit of Alpine belt from Spain to Albania, describing Triassic deposits from Betic Cordillera (Spain) and so on those of central Europe (Swiss), Bergamasco Alps (Italy), Bleiberg zone (Austria) and Mezivna deposits of Slovenia. We can see that all these deposits are similar and have a great importance for their content of Pb-Zn and F deposits, but in Albania, in Albanian Alps zone we can declare that deposits are very similar, but if in other countries here, these deposits possess very important ore deposits, in Albania they are absent. Studying hardly all geological scientific works, we concluded that and in Albania we have the possibilities to discover ore bodies, in analogy with the other countries of Alpine Belt.

An important question is valued in this paper. There is recorded that we can discover ore bodies and above Triassic deposits (in Jurassic and Cretaceous deposits) because Pb-Zn elements can migrate as hydrocarbons in upper parts.

VEÇORI TE NDERTIMIT GJEOLOGJIK TE VENDBURIMIT TE FOSFORITEVE GUSMAR

Theotaq Nika, Ndermarja Gjeologjike, Gjirokaster

Paraqiten te dhena mbi veçorit e ndertimit gjeologjik dhe te perberjes se horizontit fosfatmbartes, te shkembinjve te tavanit e te dyshemese se ketij horizonti dhe te ndertimit tektono-strukturor te tij qe jane disi te veçanta nga ato te zonave e vendburimeve te tjera te ketij lloji. Gjithashtu paraqiten nje sere faktesh e fenomenesh te vrojtuar ne kete vendburim.

HYRJE

Vendburimi i fosforiteve Gusmar ka nje ndertim dhe permbajtje te ndryshme nga ai i vendburimeve e shfaqjeve te tjera te zones tektonike Jonike. Ndertimi i tij eshte bere objekt i nje sere studimesh tematiko-pergjithesuese e artikujsh ne literaturen tone shkencore ku, krahas pershkrimit te veçorit te ndertimit, vihet re edhe ndonje pasqerimi ose lihen jashte mjaft fakte e fenomene te cilat kane rendesi per sqarimin e kushteve te formimit te fosforiteve dhe te tektonikes se brezit qendror te Kurveleshit.

Punimet e zbulimit e te shfrytezimit japin nje material te bollshem faktik qe qarteson me tej formen, perberjen dhe marredheniet e trupit mineral me shkembinjte rrethues, ndertimin tektono-strukturor te vendburimit dhe te zones perreth. Njohja e teresise se ketyre fakteve do te ndihmoje sadopak per kerkimin e objekteve te tjera te ketij lloji, ose te peraferta me te, ne antiklinalin qendror te vargut strukturor te Kurveleshit.

PERSHKRIMI I HORIZONTIT FOSFATMBAJTES

Pakoja fosfatmbajtese perbehet nga nje bashkesi shtresash fosfatit, gelqerori fosfatik, gelqerori e stralli te cilat nderthuren me njera tjetren dhe emerohet horizont fosfatmbajtes.

Ne vendburimin e Gusmarit, brenda horizontit fosfatmbajtes veçohen keto tipe mineralizimi:

1. Fosforite me teksture masive, Ndertohen nga fosforiti me trashesi nga 0.2-5 m me permbajtje mbi 20 % P_2O_5 qe arrijn deri ne 30-33 % P_2O_5 .




Fig. 1. Pamje nga dokumentimi i galerise 42 niveli 966 m

1. Fosforitet masive; 2. Zone e shkaterruar; 3. Fosforitet brezore; 4. Gelqerore fosfatike; 5. Gelqerore; 6. Argjile; 7. Mergjele; 8. Stralle; 9. Billoqe diabazesh.

View of documentation of gallery 42 level 966 m.

1. Massiv Phosphorite; 2. Tectonic Fault; 3. Bedded Phosphorite; 4. Phosphatic limestones; 5. Limestone; Clay; 7. Marl; 8. Chert; 9. Diabass blocks.




Fig. 2

Ndertohe nga 1 deri ne 3 ritme te trasha fosforiti. Ka kontakte te prera e te qarta me argjilat e dyshemese dhe gelqeroret e tavanit.

2. Fosforite me teksture brezore. Ndertohe nga ritme fosforitesh, gelqerorësh fosfatik, gelqerorësh e shtrallesh. Brenda tij veçohen shtresa e bashkesi shtresash me 15-20 % P_2O_5 . Numri i shtresave fosfatike eshte me i madh se ai i shtresave te tjera. Duke kaluar nga qendra e vendburimit ne drejtimin jugor e ne thellesi fillon e zvogelohet numri i ritmit te fosforiteve dhe shtohet numri i ritmeve te komponenteve te tjere. Trashesia e tij luhetet nga 5-7 m. Ka kontakte te prera si me tavanin, ashtu dhe me dyshemene. Shtresat dhe grupshtresat fosfatike takohen ne pjeset me te poshteme te horizontit fosfatmbajtes.

Supozojme qe mbi harten gjeologjike te rajonit ne studim eshte mbivendosur nje rrjete qelizash me siperfaqe te barabarte dhe per çdo qelize jane koduar p - tipare gjeologjike, x_j ($j = 1, 2 \dots p$). Per te percaktuar sektoret me te favorshem per kerkim te metejshem, mund te studiohet vartesia e numrit te shfaqjeve te mineralizuara ose prania (mungesa) e tyre ne funksion te tipareve gjeologjike, x_j ($j = 1, 2 \dots p$). Ne punimin e paraqitur jemi perqendruar ne studimin e pranine se shfaqjeve te mineralizuara ne funksion te tipareve gjeologjike.

Le te jete Y_i variabli binar i rastit qe paraqet pranine ose mungesen e shfaqjeve te mineralizuara ne qelizen e i -te ($i = 1, 2 \dots n$, ku n eshte numri i qelizave ne rajonin qe studiohet). Shenojme me θ_i - probabilitetin qe ne qelizen e i -te ka te pakten nje vendburim ose shfaqje te mineralizuar te tipit te kerkuar. Atehere matematikisht problemi reduktohet ne shprehjen e vartesise se probabilitetit θ_i si funksion i p -variablave gjeologjike:

$$\theta_i = f(x_{i1}, x_{i2}, \dots, x_{ip}) \quad (1)$$

Modeli me i thjeshte do te ishte modeli linear. Kjo nenkupton qe probabiliteti θ_i ne qelizen e i -te eshte postuluar si funksion linear i p -variablave gjeologjike.

$$\theta_i = \beta_0 + \sum_{j=1}^p \beta_j x_{ij} \quad (2)$$

ku mbetja $\varepsilon_i \sim N(0, \sigma^2)$ dhe $\sigma^2 = \text{Var}(\varepsilon_i)$.

Koeficientet e panjohur $\beta_0, \beta_1, \dots, \beta_p$ percaktohen me ndihmen e metodes se katroreve me te vegjel (MKV). Perdorimi i MKV-se ka dy te meta (Agterberg and Chung 1980):

a) Hipoteza e dispersionit konstant qe kerkohet ne metoden e MKV-se nuk eshte e vertete per problemin e mesiperm. Dispersioni i qelizes se i -te eshte:

$$\text{Var}(\varepsilon_i) = \theta_i (1 - \theta_i) = \mathbf{X}'_i \mathbf{b} (1 - \mathbf{X}'_i \mathbf{b})$$

ku $\mathbf{X}_i = (1, x_{i1}, x_{i2}, \dots, x_{ip})$ dhe $\mathbf{b} = (\beta_0, \beta_1, \dots, \beta_p)$.

Kjo do te thote qe dispersioni i mbetjes ne çdo qelize varet sistematikisht nga variabellet gjeologjike x_1, x_2, \dots, x_p qe i pergjigjen asaj qelize. Per rrjedhoje vleresimet $\hat{\mathbf{b}} = (\hat{\beta}_0, \hat{\beta}_1, \dots, \hat{\beta}_p)$ te perftuara me ndihmen e MKV-se nuk jane vleresime te pazhvendosura me dispersion minimal.

b) E meta e dyte konsiston ne faktin se vleresimet e probabilitetave $\theta_i = \mathbf{X}_i \mathbf{b}$ te perftuara sipas modelit (2) mund te rezultojne jashte intervalit [0,1], gje qe eshte ne kundërshtim me perkufizimin e probabilitetit θ_i .

Prandaj per problemin e mesiperm me i pershtatshem eshte modeli logjistik i Cox-it.

$$\theta_i = e^{\mathbf{X}_i \mathbf{b}} / (1 + e^{\mathbf{X}_i \mathbf{b}}) \quad (3)$$

$$\text{ku} \quad \mathbf{X}'_i \mathbf{b} = \beta_0 + \sum_{j=1}^p \beta_j x_{ij}$$

Per vleresimin e $\mathbf{b} = (\beta_0, \beta_1, \dots, \beta_p)$, Cox sugjeroi perdorimin e metodes se pergjasise maksimale, MLE (Cox 1970).

Nje e mete e perbashket e metodave te regresit ne vleresimin e potencialit mineralmbajtes te nje rajoni ne studim, konsiston ne faktin se koeficientet e regresit ndikohen nga prania e objekteve ende te pazbuluara ne rajon. Ne pergjithesi probabilitetet e vleresuara sipas modeleve te regresit jane te zhvendosura, pra mbarin gabim sistematik, dhe numri i pritshem i vendburimeve i llogaritur sipas ketyre modeleve do te jete me i vogel se numri i tyre i vertete. Korrigjimi i kesaj zhvendosje perben nje problem te veshtire dhe ende te pazgjidhur deri me sot. Megjithate, ndonese eshte e pamundur te korrigjohet efekti i kesaj zhvendosje per çdo qelize te veçante, kur njihen nje ose disa sektore te studjuar mire brenda rajonit te cilet mund te perdoren si sektore kontrolli, eshte e mundur te korrigjohet efekti i kesaj zhvendosjeje per numrin e pritshem te vendburimeve.

Me poshte, pa hyre ne detaje te karakterit matematik (lexuesi i interesuar mund t'u referohet Cox 1970, Agterberg 1974, Agterberg and Chung 1980), po shqyrtojme perdorimin e modelit logjistik te Cox-it ne prognozimin e rajonit Lumzi-Kalivar-Fushe Fjere.

Prognozimi i rajonit Lumzi-Kalivar-Fushe Fjere

Rajoni Lumzi-Kalivar-Fushe Fjere ben pjese ne formacionin vullkanik te Mirdites Qendrore. Ai perfaqeson nje fushe xeherore ku gjen shprehjen formacioni vullkanogjen me faciet e tij, ne shtrirje dhe renie. Mbeshtetur ne faktoret gjeologjike e tektoniko-minerare, brenda kesaj fushe xeherore u percaktua sheshi me perspektiv ne hartin gjeologo-strukturor 1:10000 (Fig. 1). Sheshi i zgjedhur u nda ne 411 qeliza me permasa 250 x 250 m.

Prania ne rajon e shume shfaqjeve te mineralizuara, disa prej te cilave te njohura e te studiuara me tere kompleksitetin gjeologo-strukturor, mineralogjik, gjeokimik e gjeofizik, si dhe disa shfaqje te tjera te mineralizuara qe mendohen

me rendesi praktike (Lumzi, Babune, etj.) ndihmojne drejtpersedrejti per te gjykuar mbi mineralmbajtjen ne te gjithë sheshin e perhapjes se shkembinjve vullkanogjene. Ne te njejten kohe ato sherbejne per te kontrolluar ne nje fare mase edhe vertetesine e prognozimit.

Ideja themelore per prognozim eshte kerkimi i shprehjes matematike te lidhjes se mineralizimit sulfur me faktoret kontrollues gjeologo-gjeofizike e gjeokimike. Percaktimi drejt i faktoreve kontrollues te xeherormbajtjes ne fushen xeherore perben elementin baze, nga zgjidhja drejt e te cilit varet saktesia dhe vertesia e prognozimit. Faktoret kontrollues te marre se bashku duhet te paraqesin anen tektonike, formacionale dhe gjenetike te vendosjes ne hapësire e ne kohe te mineralizimit sulfur.

Duke u mbështetur ne vrojtimet e shumta fushore, ne pergjithesimin e materialit gjeologjik te grumbulluar dhe ne evidentimin e shfaqjeve dhe te zhveshjeve te mineralizuara te rajonit u percaktuan faktoret kontrollues me te sigurte me te cilet mendohet se lidhet mineralizimi:

1. Prania e mineralizimeve paresore ose e zonave te limonitizuara eshte nje e dhene e drejtperdrejte qe lidhet me mineralizimin sulfur te baker-piritit. Kjo e dhene flet per mundesine e gjetjes se perqendrimeve te lendes xeherore me rendesi industriale.
2. Plotesia e prerjes gjeologjike te vullkaniteve me te gjitha pjeset perberese te kesaj bashkesie gjeologo-stratigrafike, nga poshte deri ne kufirin e siperm te kolones gjeologjike te rajonit. Per rajonin tone, nga poshte-lart u perdor kolona gjeologo-stratigrafike e meposhtme:

Gabro, plagjiogranite, bazalte (diabaze) masive deri ne gabro diabaze, llava jastekore bazaltike, etj. (dy nenpakot e fundit perbejne pakon e poshtme vullkanogjene); hialoandezite-bazalte, hialoandezite-dacite, llava aglomerate e keratofire kuarcore (llava brekçie), keratofire kuarcore (dacite) (keto nenpako perbejne pakon e siperm vullkanogjene) dhe rreshpe silicore radiolaritike.

3. Faktori kryesor kontrollues i mineralizimit sulfur eshte kontakti midis dy pakove vullkanogjene, pakua e siperm hialoandezite-dacite me pakon e poshtme bazaltike (diabazike).
4. Si faktor kontrollues i mineralizimit sulfur eshte marre edhe largesia e çdo qelize nga masivet plagjiogranitike.
5. Anomalia gjeokimike e bakrit (Cu).
6. Anomalia gjeokimike e zinkut (Zn).
7. Vlera e rezistences se dukshme (Rd).




Fig.1: Skema gjeologjike e perhapjes se shkembinjve vullkanogjene

A) Qafe Bari B) Lumzi-Kalivar-Fushe Fjere.

1-Deluvione; 2-Rreshpe hematitike; 3-Pako argjilite me copa; 4-Riolite; 5-Llava aglomerate hialoandezito-dacite-riolite; 6-Llava brekçie; 7-8: Llava aglomerate te hialoandezite bazalteve 9- Llava jastekore bazaltike; 10- Bazalte; 11- Gabro, gabro-diabaze; 12- Diorite kuarcore - plagjiogranite; 13- Gabro; 14- Ultrabazike; 15- Seria dajkore (a) paralele (meridionale), (b) nderprerese; 16 - Zone minerale.

Fig.1: Geological sketch of volcanic rocks

1-Deluvium; 2-Hematite schist; 3-Block in matrix sequence; 4-Rhyolites; 5-Hyaloandesite-dacite-rhyolite agglomerate lavas; 6-Breccia-lavas; 7-8: Basaltic hyaloandesite agglomerate lavas; 9 - asaltic pillow lavas 10- Basalts; 11- Gabbro, gabbro-diabases; 12- Quartz-diorites, plagiogranites; 13- Gabbro; 14- Ultrabasics; 15- Sheeted dyke complexes (a) meridional orientation, (b) cross-cutting dykes; 16 - Mineralised zone.

Ky kompleks te dhenash siguron nje prognoze te besueshme dhe te argumentuar, e cila do te ndihmoje ne orientimin e punimeve gjeologjike per pjese te caktuara te rajonit dhe ne rritjen e efektivitetit te tyre, duke veqar sektoret me perspektive qe do t'u nenshtrohen punimeve te kerkim-zbulimit. Duke pare nje per nje faktoret kontrollues te xeherezimit sulfur, shihet se ata marrin parasysh edhe mundesine e gjetjes se mineralizimit ne thelesi te ndryshme.

Nje element tjetër i rendesishem ne proceduren e prognozimit eshte dhe zgjedhja e drejte e permasave te siperfaqes njesi (qelizës). Madhesia e qelizes varet nga siperfaqja e rajonit te studjuar, nga ndertimi gjeologjik i tij si dhe nga madhesia e vendburimeve te njohura ne rajon.

Ne rastin konkret, siperfaqja qe prognozohet arrin deri ne 200 km². Ajo perfshin llojet shkembore vullkanogjene te Jurasikut. Jashte prognozimit u lane shkembinjte ultrabazike dhe plagjiogranitike. Brinja e qelizes u zgjodh 250 m. Kete madhesi e favorizon edhe madhesia e vendburimeve te njohura. Permasat e trupave xehore nuk e kalojne kete madhesi.

Per secilen nga 411 qelizat e rajonit, faktoret kontrollues te mesiperm u koduan ne menyre te pershtatshme. Si variabla gjeologjike ne modelin e regresit ne zgjodhem siperfaqet, te shprehura ne pjese te njesise, qe zene llojet kryesore shkembformuese ne çdo qelize, pranine apo mungesen ne qelize te kontaktit midis dy pakove produktive te koduar perkatesisht me 1 ose 0, largesine (km) te qendres se qelizes nga masivi plagjiogranitik, vleren mesatare te rezistences se dukshme, si dhe permbajtjet mesatare te Cu dhe te Zn. Variablet e mesiperm jane emertuar si me poshte:

1. *gab*: siperfaqja e qelizes e zene nga gabrot
2. *plg*: siperfaqja e qelizes e zene nga plagjiogranitet
3. *ppv*: siperfaqja e mbuluar nga diabaze masive, lava jastekore bazaltike
4. *agb*: siperfaqja e mbuluar nga hialobazalte
5. *psv*: siperfaqja e mbuluar nga hialoandezito-bazalte
6. *agd*: siperfaqja e mbuluar nga hialoandezite-dacite
7. *ker*: siperfaqja e mbuluar nga keratofire kuarcore
8. *pkp*: prania (1) ose mungesa (0) e kontaktit midis dy pakove vullkanogjene
9. *lqp*: largesia (km) e qendres se qelizes nga masivi plagjiogranitik
10. *Rd*: vlera mesatare (kΩm) e rezistences se dukshme ne qelize
11. *Cu*: permbajtja mesatare e Cu (%)
12. *Zn*: permbajtja mesatare e Zn (%)

Nga perpunimi paraprak rezultoi se dy variablat e fundit nuk shtojne asgje ne model, prandaj ato u perjashtuan nga shqyrtimi i metejshem. Ne mendojme se kjo lidhet me gabimin e larte analitik te percaktimit te Cu dhe te Zn me metoden spektrale.

Tabela 1. Kodimi i te dhenave dhe vleresimi sipas modelit

Nr.	Gab	plg	ppv	agb	psv	agd	ker	pkp	lqp	nvb ¹	pvb ²	pvm ³
Lumzi-Kalivar-Fushe Fjere												
1	0.0	0.0	1.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1	7.35	0	0	0.16
2	0.0	0.0	1.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1	7.14	1	1	0.17
...												
5	0.0	0.0	0.0	1.0	0.0	0.0	0.0	1	6.58	0	0	0.05
...												
8	0.0	0.0	0.0	1.0	0.0	0.0	0.0	1	6.35	0	0	0.05
9	0.0	0.0	1.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1	6.30	1	1	0.24
...												
407	0.0	1.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0	1.95	0	0	0.08
408	0.0	0.0	1.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0	1.75	0	0	0.45
Qafe Bari												
412	1.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0	1.00	0	0	0.11
413	0.0	0.5	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0	1.20	0	0	0.28
...												
447	0.0	0.0	0.0	0.0	1.0	0.0	0.0	1	1.50	1	1	0.63
448	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.9	0.0	0	1.70	0	0	0.03

- Shenim: (1) nvb - Numri i vendburimeve ose i shfaqjeve te mineralizuara ne qelize.
 (2) pvb - Prania (1) ose mungesa (0) e shfaqjeve te mineralizuara ne qelize.
 (3) pvm - Probabiliteti i pranise se mineralizimit i vleresuar sipas modelit.

Gjithashtu, vetem nje pjese e rajonit eshte mbuluar me punimet gjeofizike, keshtu qe ne shumicen e qelizave mungojne matjet per rezistencen e dukshme. Prandaj edhe rezistenca e dukshme u perjashtua nga modeli. Per verifikimin e modelit te perftuar, si rajon kontrolli u zgjodh nje sektor i studjuar mire ne vendburimin e Qafe Barit Verior-Jugor. Ky sektor permban 37 qeliza me permasa 250x250m, ne 15 prej te cilave njihen vendbrime ose shfaqje te mineralizuara. Ne secilen prej tyre u maten po ato variable gjeologjike si dhe per rajonin Lumzi-Kalivar-Fushe Fjere qe do te prognozohej. Te dhenat e mesiperme (Tabela 1) iu nenshtroan analizës regresive te Cox-it (modeli logjistik). Llogaritjet u kryen ne mikroordinator IBM-AT me programin STATA (6).

Se pari u studjua vartesia e probabilitetit te egzistences ne qelize te pakten te nje vendburimi apo shfaqjeje ne funksion te variablave *plg*, *ppv*, *agb*, *psv*, *agd*, *ker*, *pkp*, *lqp*. Nga llogaritjet (Tabela 2) rezulton se probabiliteti qe variablet e mesiperme te mos jene faktore kontrollues te mineralizimit eshte me i vogel se 0.0001. Gjithashtu shihet se prania e kontaktit midis pakove produktive eshte nder faktoret me te rendesishem kontrollues te mineralizimit. Avantazhi per mineralizim ne qelizat ku eshte i pranishem ky kontakt eshte rreth 3.8 here me i larte se ne qelizat ku ai mungon. Gjithashtu nje rol jo te vogel luan edhe distanca nga masivi plagjiogranitik. Nga llogaritjet rezulton se rritja me 1 km e distances nga masivi plagjiogranitik e ul mundesine e pranise se mineralizimit rreth 1.66 here.

Persa i perket faktit se cilet lloje shkembore jane me te favorshem per tipin e studjuar te mineralizimit, eshte e veshtire te jepet ndonje mendim sepse siç shihet edhe nga *Tabela 3* koeficientet e regresit qe i korespondojne llojeve te ndryshme shkembore jane shume te koreluar me njeri tjetrin, gje qe e ben te pamundur percaktimin e avantazhit relativ te nje lloji shkembor kundrejt llojeve te tjera. Per te gjykuar mbi adekuatet e modelit, u krahasuan te dhenat faktike mbi pranine ose jo te shfaqjeve te mineralizuara me vleresimet perkatese te perftuara sipas modelit te ndertuar. *Tabela 4* tregon qarte se modeli eshte i afte te dalloje fare mire, mbi bazen e variableve gjeologjike, rajonet ose shfaqjet e mineralizuara nga ato paminalizim. Kjo vihet re akoma me qarte ne rajonin e Qafe Barit, po te krahasohet harta e prognozimit sipas modelit, me rezultatet faktike te punimeve gjeologjike. Qelizat ku aktualisht jane lokalizuar shfaqje te mineralizuara rezultojne me probabilitet mjaft te larte. Vlerat e probabiliteteve per qelizat 416, 419 dhe 423 ku lokalizohet vendburimi i Qafe Barit, jane perkatesisht 0.77, 0.69 dhe 0.71.

Tabela 2. Koeficientet e regresit per modelin e Cox-it

Variabli	Koeficienti	Sh.M.K.	t	Prob > t	Vl. mes.
Y					.171875
plg	.1856637	1.045413	0.178	0.859	.1203125
ppv	2.291014	.8853972	2.588	0.010	.2266741
agb	.5958615	.990964	0.601	0.548	.1263393
psv	1.52175	.881393	1.727	0.085	.2208705
agd	-1.223141	1.070136	-1.143	0.254	.2627232
ker	1.163757	1.993436	0.584	0.560	.0055804
pkp	1.342931	.3191814	4.207	0.000	.415179
lqp	-.5071392	.0836185	-6.065	0.000	3.643549
bo	-1.589712	.8152529	1.950	0.052	1

Tabela 3. Matrica korelative e koeficienteve te regresit

Vur	plg	ppv	agb	psv	agd	ker	pkp	lqp	bo
plg	1.000								
ppv	0.759	1.000							
agb	0.746	0.788	1.000						
psv	0.786	0.888	0.784	1.000					
agd	0.674	0.749	0.700	0.691	1.000				
ker	0.344	0.379	0.345	0.384	0.281	1.000			
pkp	-0.160	-0.132	-0.240	-0.055	-0.207	-0.034	1.000		
lqp	-0.051	-0.202	-0.104	-0.150	-0.078	-0.006	-0.232	1.000	
bo	-0.822	-0.892	-0.812	-0.906	-0.751	-0.406	0.026	-0.085	1.000

Tabela 4. Krahasimi i daljeve dhe i probabiliteteve

Rezultati	Pr < 0.5	Pr >= 0.5	Shuma
Y = 0	357	14	371
Y = 1	48	29	77
Shuma	405	43	448

Tabela 5. Krahasimi i daljeve dhe i probabiliteteve (Rajoni i Qafe Barit)

Rezultati	Pr < 0.5	Pr >= 0.5	Shuma
Y = 0	19	3	22
Y = 1	6	9	15
Shuma	25	12	37

Modeli i perftuar eshte perdorur per ndertimin e hartes prognoze per rajonin Lumzi-Kalivar-Fushe Fjere (Fig. 2), duke llogaritur per çdo qelize probabilitetin e ekzistences ne te, e te pakten nje shfaqje te mineralizuar. Eshte e qarte se sektoret me probabilitet mbi 0.5 perbejne edhe sektoret me perspektive per kerkim te metejshem. Keto jane konsideruar si sheshe te prognozes se pare, ndersa sektoret me probabilitet 0.25-0.5 i kemi konsideruar si sheshe te prognozes se dyte.

Vleresimi i rezervave prognoze

Krahas lokalizimit te sektoreve me perspektive brenda rajonit ne studim, nje detyre tjeter e rendesishme e gjeologjise se aplikuar eshte vleresimi i potencialit mineralmbajtes te rajonit. Edhe per zgjidhjen e kesaj detyre, perhapje gjithnje e me te gjere po gjejne metodat statistikore.

Eshte e qarte se sasia e rezervave prognoze brenda nje rajoni varet nga numri i pritshem i vendburimeve ne rajon si dhe nga madhesia mesatare e vendburimeve te pritshme. Nje vleresim ekonomik me serioz do te kerkonte te shqyrtohej edhe vlera mesatare monetare e vendburimeve qe siç dihet, veç sasise se rezervave, varet edhe nga permbajtja mesatare e perberesve te dobishem, kursi i tregut, etj.

Shenojme me X_i -madhesine e nje vendburimi te mundshem ne qelize dhe me K -numrin e vendburimeve ne te.

Madhesia:

$$Y = \sum_{i=1}^K X_i \quad (4)$$

paraqet sasine e xeherorit ne qelize. Ketu K eshte madhesi rasti diskrete dhe ne pergjithesi nuk varet nga X_i . Studimet e kryera per rajone te ndryshme kane treguar se ne pergjithesi K ka shperndarje binomiale negative ndersa X_i ka shperndarje lognormale (Agterberg, 1974).

Pritja matematike dhe dispersioni i shperndarjes binomiale negative jepen nga:

$$E(K) = rq/p \quad \text{dhe} \quad \sigma^2(K) = rq/p^2 \quad \text{ku} \quad q = 1-p$$

Per shperndarjen lognormale kemi:

$$E(X) = e^{\mu + \frac{\sigma^2}{2}} \quad \text{dhe} \quad \sigma^2(X) = e^{2\mu + \sigma^2} (e^{\sigma^2} - 1)$$

ku: $\mu = E(\ln x)$ dhe $\sigma^2 = \sigma^2(\ln x)$.

Provohet (Agterberg, 1974) se per variablin e perbere Y kemi:

$$E(Y) = \frac{rq}{p} e^{\mu + \frac{\sigma^2}{2}} \quad (5)$$

$$\sigma^2(Y) = \frac{rq}{p} e^{2\mu + \sigma^2} (e^{\sigma^2} + \frac{q}{p}) \quad (6)$$

Per vleresimin e parametrave te shperndarjes binomiale negative perdoret nje procedure iterative e bazuar ne metoden e pergjasise maksimale. Si vleresim fillestar per parametrin r perdoret formula:

$$r' = \frac{\bar{x}}{s^2 - x}^2$$

ku: \bar{x} dhe s paraqesin perkatesisht vleren mesatare dhe dispersionin e zgjedhjes.

Meqenese x eshte gjithashtu vleresim i pergjasise maksimale per vleren mesatare atehere p, q dhe vlera e re e dispersionit mund te llogariten nga r dhe \bar{x} .

Vleresimet me te mira per vleren mesatare dhe dispersionin e madhesise X me shperndarje lognormale perftohen nga:

$$\hat{\alpha} = e^{\frac{\ln \bar{x}}{2}} \psi_n\left(\frac{s^2}{2}\right) \quad (7)$$

$$\text{dhe} \quad \hat{\beta}^2 = e^{2\ln \bar{x}} \left\{ \psi_n(2s^2) - \psi_n\left(\frac{n-2}{n-1} s^2\right) \right\} \quad (8)$$

ku: $\psi_n(s^2/2)$ varet nga vellimi i zgjedhjes n dhe nga dispersioni logaritmik $s^2 = s^2(\ln x)$.

$$\text{Ketu:} \quad \psi_n(t) = 1 + \frac{n-1}{n} \cdot t + \frac{(n-1)^3}{n^2(n+1)} \cdot \frac{t^2}{2!} + \frac{(n-1)^5}{n^3(n+1)(n+5)} \cdot \frac{t^3}{3!} + \dots$$

Atehere vleresimet praktike per vleren mesatare dhe dispersionin e variablit te perbere Y llogariten nga:

$$\hat{E}(Y) = \frac{rq}{p} \cdot \hat{\alpha} \quad (9)$$

$$\text{dhe} \quad \hat{\sigma}^2(Y) = \frac{rq}{p} \hat{\beta}^2 + \frac{rq}{p^2} \hat{\alpha}^2 \quad (10)$$

Le te kalojme tani ne vleresimin konkret te potencialit mineralmbajtes te rajonit qe po studjojme, duke vleresuar se pari numrin e pritshem te shfaqjeve te mineralizuara ne rajon.

Siç kemi vene ne dukje dhe me lart modelet e regresit japin gjithmone nje vleresim me te vogel per numrin e pritshem te objekteve ne rajon. Per te korrigjuar efektin e kesaj zhvendosjeje shfrytezojme te dhenat e rajonit te Qafe Barit i cili mund te perdoret si sektor kontrolli meqenese eshte nje rajon i studjuar mire. Rezultatet permblledhese per rajonin e Qafe Barit paraqiten ne tabelen 5. Nga tabela 4 shihet se 29 nga te 43 qelizat produktive ($p \geq 0.5$) sipas modelit te perftuar, jane qelizat ku faktikisht ka te pakten nje shfaqje te mineralizuar. Kjo do te thote qe neqoftese probabilitetet e vleresuara nga modeli do te ishin te pazhvendosura atehere probabiliteti qe nje qelize e prognozuar si produktive ($p \geq 0.5$) te kete te pakten nje shfaqje te mineralizuar eshte 29/43 ose 67.44%.

Per qelizat e tjera ky probabilitet eshte 48/405 ose 11.85%. Neqoftese keto probabilitete do te perdoreshin per prognozimin e sektorit te kontrollit atehere numri i pritshem i shfaqjeve te mineralizuara ne sektorin e Qafe Barit do te ishte $12 \times 0.6744 + 25 \times 0.1185 = 11$ qeliza. Por ne rajonin e Qafe Barit njihen 15 shfaqje te mineralizuara. Prandaj probabilitetet e vleresuara sipas modelit duhen korigjuar me faktorin:

$$f = 15/11 = 1.3567$$

Atehere probabilitetet e korigjuara do te jene $1.3567 \times 0.6744 = 0.915$ per qelizat produktive ($p \geq 0.5$) dhe $1.3567 \times 0.1185 = 0.16$ per qelizat jo produktive ($p < 0.5$). Keto probabilitete u korespondojne qelizave 250 x 250 m. Ne rajonin Lumzi-Kal-F. Fjere rezultojne $43 - 12 = 31$ qeliza produktive dhe $405 - 25 = 380$ qeliza jo produktive. Atehere numri i pritshem i shfaqjeve te mineralizuara ne rajonin e studjuar do te jete: $31 \times 0.915 + 380 \times 0.16 = 89$ shfaqje te mineralizuara. Megjithate jo çdo shfaqje te mineralizuar i korespondon nje vendburim. Keshtu ne rajonin e Qafe Barit ndonese shfaqje te mineralizuar kemi ne 15 qeliza njihet vetem nje vendburim. Kjo do te thote qe probabiliteti per te pasur vendburim ne nje qelize ku ka te pakten nje shfaqje te mineralizuar eshte 1/15 ose rreth 6.7%. Atehere numri i pritshem i vendburimeve ne rajonin Lumzi-Kalivar-Fushe Fjere eshte 89/15 ose rreth 5.93.




Fig.2: Harta e prognozës e vlerësuar me modelin logjistik

A) Qafe Bari B) Lumzi-Kalivar-Fushe Fjere
 1 - $p \geq 0.75$ 2 - $0.5 \leq p < 0.75$ 3 - $0.25 \leq p < 0.50$
 4 - $0.10 \leq p < 0.25$ 5 - $p < 0.10$ 6 - Numri qelizës

Fig.2. Schematic representation of probabilities estimated by logistic model

1 - $p \geq 0.75$ 2 - $0.5 \leq p < 0.75$ 3 - $0.25 \leq p < 0.50$
 4 - $0.10 \leq p < 0.25$ 5 - $p < 0.10$ 6 - Cell number

Siç kemi vëne ne dukje edhe me lart, zakonisht numri i pritshëm i vendburimeve ka shpërndarje binominale negative. Per rajonin e Qafe Barit:

$$E(K) = 1/15 \quad \text{dhe} \quad \sigma^2(K) \approx s^2(K) = 1/15$$

Fakti që $E(K) = \sigma^2(K)$, tregon që numri i pritshëm i vendburimeve në një qelizë me permasa 250 x 250 m, ka shpërndarje Puasoni. Në këto kushte në vend të formulave (9,10) që i përgjigjen shpërndarjes binominale negative, duhen përdorur formulat:

$$\hat{E}(Y) = \lambda \hat{\alpha} \quad (11)$$

$$\text{dhe} \quad \hat{\sigma}^2(Y) = \lambda(\hat{\alpha}^2 + \hat{\beta}^2) \quad (12)$$

$$\text{ku} \quad \lambda = E(K) = \sigma^2(K)$$

Per të përcaktuar vlerën mesatare dhe dispersionin e madhësive të vendburimeve, në mungesë të të dhënave me të plotë, kemi shfrytëzuar gjendjen e rezervave për vendburimet Qafe Bari, Munelle, Gurth-Spaç (Tab. 6, 7). Per arsye sekreti sasia e rezervave është dhënë në njësi konvencionale (shumëzuar me një koeficient të caktuar).

Tabela 6. Gjendja e rezervave për vendburimet e njohura

Vendburimi	Rezervat (R) ^a	Cu (%)	Metali (M) ^a
Qafe Bari	0.612	2.36	0.0144
Munelle	4.000	1.31	0.0520
Gurth-Spaç	0.768	2.25	0.0173

Duke zbatuar formulat (7,8) për sasine e rezervave dhe sasine e metalit gjejmë këto vlerësime për vlerat mesatare dhe dispersionet përkatëse:

Tabela 7. Statistikat përmbledhëse për vendburimet e njohura

Variabli	Vrojtime	Vlera Mesatare	Devijimi standart	Vlera minimale	Vlera maksimale
R	3	1.793333	1.912620	0.61200	4.00000
Cu	3	1.973333	0.577090	1.31000	2.36000
M	3	0.028041	0.021143	0.01444	0.05240
lnR ^{b)}	3	0.210436	1.024633	-0.49102	1.38629
lnCu ^{b)}	3	0.646539	0.326941	0.27004	0.85866
lnM ^{b)}	3	-3.748195	0.698037	-4.23753	-2.94885

Shënim: a) Rezervat jepen në milione njësi konvencionale
 b) $\ln R = \ln(R)$; $\ln Cu = \ln(Cu)$ dhe $\ln M = \ln(S)$.

- Per sasine e rezervave:

$$\hat{\alpha} = 1.74024$$

$$\hat{\beta}^2 = 3.55792$$

- Per sasine e metalit:

$$\hat{\alpha} = 0.0265226$$

$$\hat{\beta}^2 = 0.000567312$$

Duke kryer llogaritjet sipas formulave (11,12) gjejme keto vleresime per sasite e pritshme dhe dispersionet e sasise se rezervave dhe te metalit ne nje qelize produktive:

- Per rezervat:

$$\hat{E}(Y)=0.116016 \text{ dhe } \hat{\sigma}^2(Y)=0.439088$$

- Per metalin:

$$\hat{E}(Y)=0.001768 \text{ dhe } \hat{\sigma}^2(Y)=0.0000847168$$

Nga teorema qendrore limite variabli $Z = \sum_{i=1}^n Y_i$ kur n shkon ne infinit ka shperndarje normale. Per rajonin Lumzi- Kalivar- Fushe Fjere kemi $n = 89$. Atehere sasite e pritshme te rezervave dhe te metalit per te gjithë rajonin e studjuar dhe devijimet standarte perkatese do te jene:

- Per rezervat:

$$\hat{E}(Z)=10.3256 \text{ dhe } \hat{\sigma}(Z)=6.2513$$

- Per metalin:

$$\hat{E}(Z)=0.157352 \text{ dhe } \hat{\sigma}(Z)=0.086832$$

Perfundimisht, sasia e pritshme e rezervave prognoze ne rajonin Lumzi- Kalivar-Fushe Fjere eshte rreth 10.3 milion njesi konvencionale ndersa sasia e pritshme e metalit rreth 157000 njesi.

Ne sheshet e prognozes se pare ($p \geq 0.5$) sasite e pritshme te mineralit e metalit jane perkatesisht $31 \cdot 0.915 \cdot 0.116016 = 3.3$ milion njesi konvencionale dhe $31 \cdot 0.915 \cdot 0.001768 = 50000$ njesi, ndersa ne sheshet e prognozes dyte ($p < 0.5$) priten perkatesisht $380 \cdot 0.16 \cdot 0.116016 = 7$ milion njesi mineral dhe $380 \cdot 0.16 \cdot 0.001768 = 107000$ njesi metal.

Megjithate per shkak te numrit te kufizuar te te dhenave mbi te cilat mbeshtetet prognoza gabimet perkatese te vleresimit jane relativisht te larta. Me 67 % siguri mund te pohojme se rezervat e pritshme luhaten nga 4 ne 16.6 milion njesi konvencionale, ndersa sasia e pritshme e metalit luhetet nga 70500 ne 244000 njesi.

PERFUNDIME

Metodat statistikore ofrojne nje mjet mjaft efektiv per prognozimin e potencialit mineralmbajtjes te rajoneve gjeologjike. Per lokalizimin e sektoreve me perspektive brenda rajonit qe studjohet, nje ndihmese te madhe mund te jape analiza e regresit shumepermasor, e cila lejon te studjohet mundesia e pranise se mineralizimit ne funksion te faktoreve te ndryshem gjeologjike, gjeokimike e gjeofizike. Ne menyre te veçante, modeli logjistik i Cox-it siguron nje instrument mjaft efektiv per verifikimin e hipotezave te punes dhe per shqyrtimin e faktoreve te ndryshem gjeologjike si faktore kontrollues te mineralizimit. Modeli i Cox-it lejon gjithashtu te llogaritet nje karakteristike numerike adekuate per vleresimin e shkalles se mundesise objektive te pranise se mineralizimit, per çdo sektor brenda rajonit te studjuar, siç eshte ai i propabilitetit te xeherombajtjes, duke siguruar keshtu nje instrument praktik per ndertimin e hartave te prognozimit.

Metodat statistikore lejojne gjithashtu edhe nje vleresim me te bazuar per sasine e rezervave te pritshme ne rajon dhe per sigurine e ketij vleresimi. Duke kombinuar modelin e Cox-it me shperndarjen binomiale negative ose ate te Puassonit, mund te percaktohet numri i pritshem i vendburimeve ne rajon, ndersa shperndarja lognormale lejon te karakterizohet madhesia mesatare e vendburimeve te pritshme.

LITERATURA

- Agterberg F.P., 1974, Developments in Geomathematics: Elsevier, Amsterdam.
- Bezhani V., Lula P., Prognoza bakermajtjes e rajonit Fushe Arrez-Lumzi-Kalivar, Fondi i ISPGJ-se, Tirane, 1991.
- Chung C.F., Agterberg F.P., 1980, Regression Models for Estimating Mineral Resources from Geol. Map Data, Mathemat. Geol. Vol. 12, No. 5.
- Cox, D.R., 1970, Analysis of binary data, Methuen, London, 142 p.
- Kamberaj R., Kuka N., 1986, Prognozimi per xeherore sulfurore bakermajtjes ne rajonin Porave-Palaj-Qerret, Bul. Shk. Gjeol., Nr. 2.
- STATA Corp. 1995, Stata Statistical Software: Release 4.0, College Station, Texas 77840, USA

Redaktor: Prof. Dr. Afat SERJANI

SUMMARY

Using Statistical Methods for Estimating Mineral Resources of the Geological Areas

The paper investigate the issue of the estimation the mineral resources in the geological areas throught making use of the statistical methods.

The main idea for the forcast is to find out the mathematical relation between occurrence probability of mineral deposits and the geological-geophysical and geochemical features. To investigate controlling factors and for detecting favorable areas for mineral exploration within the region, it is recommended to use the Cox's logistic model:

$$\theta_i = e^{\mathbf{X}_i \mathbf{b}} / (1 + e^{\mathbf{X}_i \mathbf{b}}) \quad (3)$$

where:

$$\mathbf{X}_i \mathbf{b} = \beta_0 + \sum_{j=1}^p \beta_j x_{ij}$$

Here θ_i is the probability that in the cell i has at least a mineral deposit or occurrence, while $X_i = (1, x_{i1}, x_{i2}, \dots, x_{ip})$ shows the values of the geological variables x_1, \dots, x_p for the cell i .

The unknown coefficients $\beta_0, \beta_1, \dots, \beta_p$ are estimated using the Maximum Likelihood method.

To estimate the expected resources in the study region it is recommended to use a combination of the Cox model with the other statistical methods. Negative binomial or the Puason distribution provide a proper estimation of the expected number of the mineral deposits in the region, while lognormal distribution can be used to describe their sizes.

The above procedure is used during the estimation of mineralisation potentiality in the region Lumzi-Kalivar-Fushe Fjere, which is located in the volcanic formation of Central Mirdita.

TREGUESI I LENDES (CONTENTS)

Instituti i studimeve dhe Projektmeve te Gjeologjise, ne prag te 35 vjetorit te themelimit nga Ass. Prof. Adil NEZIRAJ - Drejtor i Institutit (Geological Research and Design Institute in Tirana, Albania at the threshold of 35th centuary by Ass. Prof. Adil NEZIRAJ - Director).....faqe 3

STRATIGRAFI-PALEONTOLOGJI
(STRATIGRAPHY-PALAEONTOLOGY)

J. Hoxha - Diskutim plotesues mbi prerjen teresore stratigrafike te rajonit te Gashit. (Supplementary Discussion on the full Stratigraphic Section of the Gashi Region).....faqe 5

MINERALE TE DOBISHME (MINERAL ORES)

- A. Tershana - Brezi ofiolitik perendimor ne Albanidet dhe titanomagnetitmbajtja e tij. (Wester-Ophiolitic Belt in Albanides and his Titano-magnetite-bearing).....faqe 19
- M. Zaçaj - Kerkimi i metejshe i arit ne Shqiperi (Further Research of Gold in Albania).....faqe 33
- Y. Muceku, S. Burri - Argjilat industriale te Shengjunit te rrethit te Matit, gjeologjia dhe kushtet e formimit te tyre. (Industrial Clays of Shengjun-Mati Region, Geology and Environment of Formation).....faqe 41
- D. Shkupi, Z. Bicaj, L. Peza, M. Shabani, M. Nikolla - Mineralizimet sedimentare te Pb-Zn ne depozitimet triasike te treves Alpine dhe mundesia e gjetjes se tyre ne Shqiperine e Veriut-Rajoni Shkoder. (Sedimentary Mineralizations of Pb-Zn in Triassic Formations of Alpine trough and Possibilities of their Findings in Northern Albania Shkodra Region).....faqe 51
- Th. Nika - Veçorite e ndertimit gjeologjik te vendburimit te fosforiteve Gusmar. (Some Features of Geological Construction of Gusmari Phosphorit. Deposit)faqe 75

Husain V., Khan H., Qureshi K.M. and German K. - The Veintype Barite Mineralization in Hazara, Pakistan. (Mineralizimi i tipit damaror te Baritit ne Hazara Pakistan).....faqe 83

HIDROKARBURE (HYDROCARBONS)

Gj. Foto - Konsiderata mbi sasine dhe kushtet e ndodhjes se rezervave te mbetura te naftes ne vendburimet ekzistuese. (Consideration of the Quantity and Condition of Oil Remaining Reserves in Exploited Oil Fields in Albania).....faqe 93

PETROLOGJI-GJEOKIMI PETROLOGY-GEOCHEMISTRY)

K. Manika, J. Fabries - Aplikime te gjeobarometrit te oksigjenit Ol-Opx-Sp ne percaktimin e gjendjes se oksidimit te peridotiteve te masivit ofiolitik te Shebenikut (Application of the Oxygen barometres to Ol-Opx-Sp for Determination of Oxidization of Peridotites of Shebenik-Ophiolitic Massif).....faqe 103

A. Tashko., O. Rover., A. Teršana - Biotite-Granitic Dikes with Accessory Monazite Cutting the Mantle Ultramafic Rocks of Bulqiza Ultramafic Massif (Albania): Witness of a "Hot" Obduction (Dajka granitobiotitike ne monacit akcesor qe nderpresin ultrabaziket mantelore te masivit ultrabazik te Bulqizes. Dëshmi e nje obduksioni te "nxehte"..... faqe 115

A. Serjani - Some General Features of the Chemical Composition of Phosphorites (Disa veçori te Pergjitheshme te perberjes kimike te fosforiteve..... faqe 127

GJEOMATEMATIKE (GEOMATHEMATICS)

N. Kuka, P. Lula - Perdorimi i metodave statistike ne vleresimin e potencialit mineralmbajtes te nje rajoni (Using statistical Methods for Estimating Mineral Resources of the Geological Areas).....faqe 149

KERKESAVE NDAJ AUTOREVE PER ARTIKUJT SHKENCORE

Çdo artikull per botim ne "Buletin e Shkencave Gjeologjike" duhet te shoqerohet me nje leter ne te cilen autori te theksoje se materiali nuk eshte botuar me pare as i teri dhe as pjeserisht. Ne rastin kur jane disa autore te percaktohet kush eshte autori qe ndjek direkt proceduren e botimit.

Autori duhet te pasqyroje qarte subjektin e trajtuar ne artikull. Thelbi i artikullit paraqitet ne nje permbledhje (abstrakt) disa rreshta. Pastaj paraqitet hyrja, permbajtja, perfundimet e studimit ose diskutimi dhe literatura

Redaksia pranon artikuj origjinale ne te gjitha fushat e gjeologjise edhe pranohen per botim njoftime shkencore dhe diskutime ne te gjitha degjet e gjeoshkencave. Revista boton gjithashtu materiale te natyres tregtare-prodhuese ne fushen e studimit, shfrytezimit e perdorimit te lendeve te para minerale.

Ne çdo artikull duhet te jepet detyrimisht qysh ne fillim shkurtimisht historiku i studimeve per problemin qe trajtohet duke vleresuar ne menyre kritike pikpamjet e paraqitura ne botimet e meparshme dhe duke bere referencat e literatures se meparshme.

Artikulli pranohet i daktilografuar ne dy kopje ne leter format A-4: Preferohet i regjistruar ne diskete, ne kete rast pranohet nje kopje e tekstit. Disketa kthehet. Artikulli pranohet deri 8 faqe te daktilografuara perfshi edhe figurat (Faqja e daktilografuar duhet te kete 32 rradhe ne gjeresi 18 cm). Titulli shkruhet me shkronja te medha. Adresa e autorit shkruhet menjehere pas emrit. Nentitujt shkruhen ne mes te faqes me shkronja te vogla. Literatura shkruhet sipas rendit alfabetik te autoreve pamvaresisht ne se jane autore te vendit apo te huaj. Pas autorit shkruhet viti i botimit, pastaj titulli i botimit, titulli i organit ku eshte botuar faqet dhe vendi i botimit.

Figurat pranohen te disenjuara ne leter transparente ose te fotokopjuara ne leter te bardhe format A4. Ato duhet te jene te punuara mire, pastër dhe me kontrast. Titulli i figures dhe dëjtura e saj duhet te shkruhen ngjitur figures ne dy gjuhë (shqip dhe anglisht). Pamvaresisht nga kjo edhe ne fund te artikullit duhet te jepet lista e figurave dhe dëjturat e tyre ne dy gjuhë. Figurave mbrapa in shkruhet emri i autorit dhe titulli i shkruhet (me laps). Figura me permasa me te medha se 10.0 x 16.0 cm nuk pranohen. Nuk pranohen gjithashtu figura apo tekst i botuar me pare ne Buletin e Shkencave Gjeologjike.

Referimet ne teks per literaturen behen me mbiemrin e autorit dhe vitin e botimit. Artikulli duhet te shoqerohet e me nje permbledhje ne nje faqe ne gjuhën angleze. Redaksia pranon edhe artikuj ne gjuhën angleze. Ne kete rast permbledhja duhet te paraqitet ne gjuhën shqip. Artikulli duhet te jete redaktuar nga specialiste te gjuhës angleze. Pergjegjësia per nivelin gjuhësor te paraqitjes bie mbi vete autorin.

Keto kërkesa jane edhe per artikujt e dorëzuar me pare ne redaksi, prandaj jane te lutur autorët qe desherojne t'i botojne te interesohen per rregullimin e tyre.

Autoret marrin 10 separate te artikullit te botuar, pamvaresisht nga numri i autoreve.

Mbas botimit te artikullit I.S.P. te Gjeologjise si homes i revistes Buletini i Shkencave Gjeologjike ruan te drejten e proneses mbi te.

KREDAKTORI

Dr. Alaudin Kodra
Drejtuës Kerkimesh



BULETINI I SHKENCAVE GJEOLGJIKE

NR. 1,2 1996

Pergatitur ne I.S.P. te Gjeologjise nga Departamenti i Dokumentacionit

Redaktor Pergjegjes: A. Serjani
Formular ne kompjuter: Th. Zoto
Hedhur ne kompiuter: V. Male, F. Zaimi
Dizinjimi: M. Konomi

Tirazhi: 200 kopje **Formati: 23.5 x 15.5 cm**
18.5 x 13.5 cm

Botuar Ne shtypshkronjen "GJERGJ FISHTA"

TIRANE, 1997
